



**Instrumenti për ndihmë paraqesë (IPA)  
i Bashkimit Evropian**



# **Përgatitja e planeve rajonale për menaxhimin me mbeturinat dhe vlerësimin strategjik të mjedisit jetësor për rajonin lindor dhe ate verilindor**

## **Vlerësimi strategjik i mjedisit jetësor Raporti për Planin rajonal për menaxhimin me mbeturinat për rajonin verilindor**

### **Përmbledhje jo-teknike**





„Përgatitja e planeve rajonale për menaxhimin me mbeturinat dhe vlerësimin strategjik të mjedisit jetësor për rajonin lindor dhe ate verilindor “  
(EuropeAid/130400/D/SER/MK)

Projekt raporti për vlerësimin strategjik të mjedisit jetësor për planin rajonal për menaxhimin me mbeturinat për rajonin verilindor



**ENVIROPLAN S.A. (Udhëheqës) – C&E GmbH – BT Engineering Ltd”**

23 Perikleous str  
15344 Gerakas/Athinë - Greqi  
Tel: +30 210 6105127 / 8  
Faksi: +30 210 6105138  
Email: [fl@enviroplan.gr](mailto:fl@enviroplan.gr)

Zyra e Projektit:  
Ivan Kozarov 53  
1000 Shkup  
Tel: +389 2 2773487  
Faks: +389 2 2273497

Projekti: **„ Përgatitja e planeve rajonale për menaxhimin me mbeturinat dhe vlerësimin strategjik të mjedisit jetësor për rajonin lindor dhe ate verilindor “**  
Numri: EuropeAid/130400/D/SER/MK

Titulli i dokumentit: Raporti për vlerësimin strategjik të mjedisit jetësor për planin rajonal të menaxhimit me mbeturinat për rajonin verilindor

Statusi: Projekt

Data: maj, i vitit 2014

Klienti: Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJHP)

Përgatiti: **Menka Spirovsk**a, biologe dhe eksperte e autorizuar për vlerësimin strategjik të mjedisit jetësor (Çertifikata nr. 07-2037/26 nga 29.07.2009 e dhënë nga MMJPH)  
**Julijana Nikova**, inxhinieri e teknologjisë inorganike dhe eksperte e autorizuar për VSNMJ;  
**Iskra Stojanova**, Këshilltare juridike  
**Konstantia Paschali-Manou**, ekspert kryesor 2, ekspert i VSNMJ-së

Kontrolloi: **Konstantia Paschali-Manou**, ekspert kryesor 2, ekspert i VSNMJ-së

Miratoi: **Theofanis Lolos** – Udhëheqës i ekipit

Data: ..../..../2014



## PËRMBAJTJA

<b>1.</b>	<b>PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE .....</b>	<b>4</b>
1.1	HYRJA .....	4
1.2	PREZANTIMI I VLERËSIMIT STRATEGJIK TË MJEDISIT JETËSOR .....	4
1.2.1	<i>Koordinimi i përgatitjes së PRMM dhe procedurës së VSMJ .....</i>	5
1.2.2	<i>Metodologjia e VSMJ .....</i>	5
1.2.3	<i>Procesi i selektimit, përcaktimit i qëllimit dhe pjesëmarrja e publikut .....</i>	5
1.2.4	<i>Aktivitetet e realizuara në kuadër të VSMJ .....</i>	6
1.3	SHQYRTIM I SHKURTËR I PËRMBAJTJES SË PLANIT, QËLIMEVE TË TIJA KRYESORE DHE KORELACIONI I TYRE ME PLANE DHE PROGRAME/DOKUMENTE PLANORE RELEVANTE TË TJERA .....	6
1.3.1	<i>Shqyrtim i shkurtër i përmbajtjes së Planit .....</i>	6
1.3.2	<i>Lënda dhe qëllimet kryesore të Planit .....</i>	7
1.3.3	<i>Korelacioni i qëllimeve të PRMM me qëllimet e strategjive të tjera kombëtare relevante, planet dhe programet .....</i>	7
1.4	ASPEKTET RELEVANTE TË GJENDJES AKTUALE TË MJEDISIT JETËSOR .....	8
1.5	KARAKTERSITIKAT E MJEDISIT JETËSOR TË RAJONIT QË DO TË JETË I TANGUAR NË MËNYRË TË RËNDËSISHME DHE GJENDJA E MUNGESËS SË REALIZIMIT TË PLANIT .....	9
1.6	RAJONET PREJ NJË RËNDËSIE TË VEÇANTË NGA ASPEKTI I MBROJTJES SË ZOGJVE TË EGËR DHE TË HABITATEVE .....	10
	<b>QËLLIMET E MBROJTJES SË MJEDISIT JETËSOR TË PËRCAKTUARA NË NIVEL NDËRKOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR .....</b>	<b>10</b>
1.7	ANALIZA E ALTERNATIVAVE .....	10
1.8	NDIKIMET E MUNDSHME TË RËNDËSISHME NË MJEDISIN JETËSOR .....	11
1.9	MASAT PËR ZBUTJE .....	24
1.10	PLANI PËR MONITORIMIN MBI ZBATIMIN E PLANIT NGA ASPEKTI I MBROJTJES SË MJEDISIT JETËSOR .....	24
1.11	PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET .....	24
1.11.1	<i>Përfundimet .....</i>	24
1.11.2	<i>Rekomandimet .....</i>	27

## LISTA E TABELAVE

<b>Tabela 1</b>	Skenari 3b dhe rindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta/të egra .....	11
<b>Tabela 2</b>	Ndikimet e mundshme pozitive të shkaktuara nga realizimi i skenarit të rekomanduar C3b dhe rindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta / të egra .....	12
<b>Tabela 3</b>	Ndikimet e mundshme negative të shkaktuara nga realizimi i skenarit të propozuar C3b dhe rindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta /të egra .....	15
<b>Tabela 4</b>	Ndikimet kumulative dhe sinergjike të shkaktuara nga realizimi i aktiviteteve në skenarin e rekomanduar 3b dhe rindërtimin e deponive ekzistuese të parregullta/të egra .....	22



## 1. PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

### 1.1 Hyrja

Përgatitja e Planit rajonal për menaxhimin me mbeturinat dhe Vlerësimi Strategjik i Mjedisit Jetësor (EuropeAid/130400/D/SER/MK) do të financohen në kuadër të masës 3.2 të Programit operativ për zhvillimin rajonal 2007-2009- vendosjes së një sistemi të integruar dhe financiar të qëndrueshëm për menaxhimin me mbeturinat.

Vendosja e menaxhimit rajonal me mbeturinat, si dhe mundësia që rajonet t'i koordinojnë aktivitetet dhe funksionet e menaxhimit me mbeturinat në emër të komunave anëtare është rekomandim kyç i Strategjisë Nacionale për Menaxhimin me Mbeturinat (SNMM) për periudhën 2008-2020 dhe Planit Nacional për Menaxhimin me Mbeturinat (PNMM) për periudhën 2009-2015.

Komisioni ndërkomunal për menaxhimin me mbeturinat për rajonin verilindor është themeluar kohëve të fundit dhe është plotësisht funksionale. Bordi ndërkomunal<sup>1</sup> duhet të shihet si trup plotësues i Ndërmarrjes Ndërkomunale për Menaxhimin me Mbeturinat, me çka bëhet një dallim i qartë midis planifikimit / kontraktimit të marrëveshjeve të punës, që do të rezultojë me një transparencë më të madhe dhe efikasitet potencial më të madh të harxhimeve.

Plani rajonal për menaxhimin me mbeturinat për rajonin verilindor përgatitet në përputhje me Strategjinë Nacionale për Menaxhimin me Mbeturinat, Planin Nacional për Menaxhimin me Mbeturinat edhe me Ligjin për Menaxhimin me Mbeturinat („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr. 68/04, 71/04, 107/07, 102/08, 143/08, 124/10, 51/11, 123/12, 147/13 dhe 163/13).

Direktiva e VSNMJ (2001/42/BE) dhe Ligjin e Mjedisit Jetësor („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13 dhe 42/14) që përcaktojnë se planet dhe programet e përcaktuara, të cilat mund të kenë ndikim të rëndësishëm ndaj mjedisit jetësor, të jenë lëndë të Vlerësimit Strategjik të Ndikimit ndaj Mjedisit Jetësor (VSNMJ).

### 1.2 Prezantimi i vlerësimit strategjik të mjedisit jetësor

Procedura e VSMJ është definuar në Kapitullin X të Ligjit të Mjedisit Jetësor („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13 dhe 42/14), sipas së cilës VSMJ zbatohet për dokumentet e planit në fushën e bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, energjetikës, industrisë, minierave, transportit, zhvillimit rajonal, telekomunikacionit, menaxhimit me mbeturinat, menaxhimit me ujërat, turizmit, planifikimit hapësinor dhe atij urbanistik dhe përdorimit të tokës, për Planin kombëtar ekologjik aksional dhe planet lokale ekologjike akcionale, si dhe për të gjitha dokumentet strategjike, planore dhe programore, me të cilat përfshihet zbatimi i projekteve për të cilat zbatohet vlerësimi i ndikimit të projektit ndaj mjedisit jetësor.

Vlerësimi Strategjik i Mjedisit Jetësor (VSMJ) është proces sistematik që parashikon masa të përcaktuara parandaluese me të cilat do të sigurohet mbrojtja e të gjitha aspekteve potenciale, në fazën e planifikimit ose sjelljes së vendimit, në nivel të “aksioneve” ose politikave, planeve dhe programeve strategjike.

<sup>1</sup> Komuna e Nagoriçanit të Vjetër vendosi të mos merrë pjesë në Bordin Rajonal për menaxhimin e mbeturinave



Qëllimi i VSMJ është për të verifikuar se informacionet për efektet e rëndësishme ndaj mjedisit jetësor të Planit janë mbledhur dhe janë vënë në mbikëqyrje personave që vendosin, si gjatë përpunimit të Planit, ashtu edhe para miratimit të tij. Sipas kësaj, VSMJ është komponenti kyç i zhvillimit të qëndrueshëm, i fokusuar në mbrojtjen e mjedisit jetësor. VSMJ, gjithashtu, e mundëson pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes dhe e rritë transparencën.

### 1.2.1 Koordinimi i përgatitjes së PRMM dhe procedurës së VSMJ

Procedura e VSMJ zbatohet paralelisht me hartimin e Planit. Koordinimi midis procedurës së VSMJ dhe përgatitjes së PRMM është arritur përmes një bashkëpunimi të ngusht dhe përfshirjes së anëtarëve të ekipit (ekipit të VSMJ dhe të PRMM), komitetit mbikëqyrës, organit kontraktues dhe organit përgjegjës për realizimin teknik të monitorimit të Planit në të gjitha fazat e projektit, nëpërmjet analizës së literaturës, shqyrtimit të mundësive teknike dhe politike, revizionit të gjendjes aktuale të mjedisit jetësor dhe vlerësimit të opsioneve, zgjedhjes dhe përcaktimit të vëllimit të vlerësimit strategjik të mjedisit jetësor, konsultimit të publikut etj. Anëtarët e ekipit, palët e interesuara dhe shfrytëzuesit e projektit kanë marrë pjesë në puntori dhe mbledhje të shumta të punës, të organizuara në hapësirat e Qendrës Rajonale për Zhvillim të Rajonit Verilindor të Kumanovës, zyra e projektit në Shkup edhe në hapësirat e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

### 1.2.2 Metodologjia e VSMJ

Procedura e VSMJ i përfshinë hapat në vijim: selektimin, përcaktimin e vëllimit, përgatitjen e raportit nga VSMJ, konsultimin e publikut, dhënien e mendimit përfundimtar nga VSMJ dhe monitorimin.

### 1.2.3 Procesi i selektimit, përcaktimit i vëllimit dhe pjesëmarrja e publikut

Në pajtim me nenin 65 paragrafi 2 i Ligjit të Mjedisit Jetësor dhe neni 3 paragrafi 10 i Dekretit të strategjive dhe Programeve, duke i përfshirë ndryshimet në strategjitë, planet dhe programet e këtilla, për të cilat detyrimisht zbatohet procedura për vlerësimin e ndikimit të tyre ndaj mjedisit jetësor dhe shëndetit të njerëzve („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr. 153/07 dhe 45/11), menaxhimi me mbeturinat është çështje për të cilën procedura për vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit jetësor dhe shëndetit të njerëzve është e detyrueshme.

Fazat e selektimit dhe përcaktimit të vëllimit përfshijnë: përcaktimin e nevojës për zbatimin e VSMJ, identifikimin e subjekteve të interesuara dhe përgatitjen e dokumenteve në bazë të të cilave MMJPH do të jep Aktvendim për vëllimin e VSMJ-së.

Faza e selektimit dhe përcaktimi i sferës së VSMJ u zbatua përmes disa mbledhjeve dhe konsultimeve të punës me subjektet e interesuara dhe ekspertët e përfshirë në përgatitjen e Planit. Në këto mbledhje u përcaktuan problemet kyçe të mjedisit jetësor, qëllimet, qëllimet kuantitative dhe indikatorët që do të ishin relevant për vlerësimin e Raportit të VSMJ-së.

Komentet dhe propozimet që dolën nga këto konsultime janë marrë parasysh në Vendimin për zbatimin e procedurës së VSMJ-së, vëllimin e VSMJ-së dhe Raportin nga VSMJ-ja.



Vendimi dhe formularët e përgatitur për zbatimin e procedurës së VSMJ-së, korrelacioni i qëllimeve të PRMM-së me dokumentet kombëtare strategjike, të planit/ programimit dhe harta e rajonit janë publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunave të rajonit më 02.04.2014 dhe ishin në dispozicion për shqyrtim publik për një periudhë prej 15 ditësh. Në afatin e parashikuar për shqyrtim publik, nuk u dorëzuan komente, propozime ose kundërshtime lidhur me vendimin e publikuar dhe dokumentet shoqëruese.

#### 1.2.4 Aktivitetet e realizuara në kuadër të VSMJ

Datë e parashikuar	Shkalla e përgatitjes / fazës
nëntor 2013	Prezantimi i procedurës për VSMJ para publikut të tanguar, 19.11.2013, Kumanovë
janar 2014	Përgatitja e formularëve dhe vendimit për zbatimin e procedurës për VSMJ , 16.01.2014 , Kumanovë
prill 2014	Vendimimi për zbatimin e VSMJ – i lëshuar dhe i publikuar në ueb faqen e MMJPH
prill 2014	Vëllimi i Raportit nga VSMJ dhe qëllimet e përcaktuara dhe të publikuara në ueb faqen e MMJPH
prill 2014	Njoftim nga MMJPH për pranimin e Aktvendimit nr.15-4451/2 nga 24.04.2014
maj 2014.	Dokument Projekt i Planit dhe Projekt Raporti i VSMJ – të publikuara
maj-qershor 2014	Mendim nga MMJPH për pajtueshmërinë e raport projektit nga VSMJ me kërkesat e legjislacionit kombëtar
qershor 2014	Konsultimi me publikun dhe subjektet e interesuara në lidhje me dokumentin e planit dhe Raportin nga VSMJ
fundit i qershorit 2014	Konsultim i kompletuar me publikun
fundit i qershorit 2014	Analiza e komenteve të marra nga publiku
	Revizioni i dokumentit të planit në bazë të informacioneve të mbledhura përmes konsultimeve
	Përfundimi i Raportit nga VSMJ
korik	Mendimi përfundimtar për raportin nga VSMJ – publikimi i tij
	Miratimi i dokumentit të planit

### 1.3 Shqyrtim i shkurtër i përmbajtjes së Planit, qëllimeve të tija kryesore dhe korelacioni i tyre me plane dhe programe/dokumente planore relevante të tjera

#### 1.3.1 Shqyrtim i shkurtër i përmbajtjes së Planit

Plani Rajonal për Menxhimin e Mbeturinave (PRMM) është një instrument i rëndësishëm, që kontribuon drejt zbatimit dhe realizimit të politikave dhe qëllimeve kuantitative të përcaktuara në fushën e menaxhimit me mbeturinat në nivel kombëtar dhe në nivel të BE-së. Për këtë qëllim, përgatitet Plan Rajonal për Menaxhimin me Mbeturinat (PRMM) për rajonin verilindor (RVL). Rajoni verilindor (RVL) i përfshinë komunat në vijim: Kratovën, Kriva Pallankën, Kumanovën, Likovën, Rankovcën, Nagoriçanin e Vjetër. Komuna e Nagoriçanit të Vjetër vendosi të mos bashkangjitet në PRMM.

Në Projekt PRMM, qëllimet kryesore janë përcaktuar në pajtim me hierarkinë e mbeturinave, të vendosura me Direktivën Kornizë për mbeturinat.

Projekti PRMM përshkruan skenarë të ndryshëm për menaxhimin e qëndrueshëm me mbeturinat në RVL, që përfshinë edhe opsione të ndryshme, siç janë:

- Parandalimi i mbeturinave dhe reduktimi i tyre në minimum,



- Grumbullimi i mbeturinave (opsione për grumbullimin e mbeturinave të kombinuara, grumbullimi i materialeve të thata që mund të riciklohen, grumbullimi i bio-mbaturinave, pikave jeshile, opsione për transferimin e mbeturinave),
- Opsione për riciklimin dhe shfrytëzimin (kapacitetet për shfrytëzimin e materialeve – KSHM, riciklimi i bio-mbaturinave, instalimeve për trajtimin mekanik-biologjik (TMB), stabilizimi mekanik-biologjik (SMB)),
- Opsione për shfrytëzimin e mbaturinave (trajtim termik i mbaturinës së fortë ose oksidimi termik apo insenerimi),
- Opsione për mënjanimin e mbaturinave (deponisë).

Më tutje, projekt PRMM i merr para sysh opsionet/modelet për sanimin e deponive të egra egzistuese. Opsionet për sanim të deponive të egra ekzistuese janë:

- Mbyllja, rehabilitimi dhe rikultivimi i deponive komunale,
- Mbyllja dhe rehabilitimi i deponive të egra dhe deponive të egra të braktisura.

Zgjedhja përfundimtare e metodës për planin e rehabilitimit mund të bëhet vetëm pas një studimi të detajuar të tokës dhe ujërave nëntokësore, apo studimeve që nuk bien në vëllimin e këtij projekti.

### 1.3.2 Lënda dhe qëllimet kryesore të Planit

Plani rajonal për menaxhimin me mbaturinat është element kyç në politikën rajonale, me të cilën sigurohet korniza strategjike i cili do të mundësoj që në tërësi rajoni të përparoj shpejtë drejt mënyrave më të qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit të mallrave, pastaj riciklimit ose shfrytëzimit sa më shumë që të jetë e mundur nga mbaturinat e krijuara. Ai gjithashtu, ka një rol të rëndësishëm në përcaktimin e kapaciteteve aktuale të rajonit për menaxhimin me mbaturinat dhe vendosjen e infrastrukturës për menaxhimin me mbaturinat që do të duhet të ndërtohet për tu përmbushur nevojat e ardhshme.

Qëllimi i Planit rajonal për menaxhimin me mbaturinat është që t'i ndërmer parimet dhe prioritetet e përcaktuara në Strategjinë kombëtare dhe Planin kombëtar për menaxhimin me mbaturinat dhe të njejtat ti zhvillojë në kornizë koncizë praktike që do t'i mundësojë rajonit të lëviz drejt praktikave të qëndrueshme në të ardhmen.

Qëllimet e Planit për menaxhimin me mbaturinat dhe indikatorëve në lidhje me hierarkinë për menaxhimin me mbaturinat janë: parandalimi i mbaturinave dhe reduktimi i tyre në minimum, grumbullimi i mbaturinave komunale (shërbimet dhe shkalla e mbulimit), riciklimi dhe shfrytëzimi i mbaturinave, mënjanimi i mbaturinave, duke përfshirë reduktimin e mbaturinave biodegradale në minimum, rrjedhave të veçanta të mbaturinave, mbylljen, rehabilitimin dhe rikultivimin e deponive komunale edhe deponive të egra, kthimin e harxhimeve, trajnimin e vetëdijes së publikut.

### 1.3.3 Korelacioni i qëllimeve të PRMM me qëllimet e strategjive të tjera kombëtare relevante, planet dhe programet

Për qëllimet e vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit jetësor, u analizuan një numër i caktuar i planeve, programeve dhe strategjive kombëtare nga sektorë të ndryshëm, si dhe qëllimet e tyre kryesore. Në raportin e VSMJ është dhënë një pasqyrë e shkurtër e qëllimeve kryesore të këtyre dokumenteve kyçe planore, që koorelacioni i tyre me qëllimet e PRMM, si dhe aktivitetet e të cilët mund që të kontribuojnë drejt realizimit të PRMM. Në Aneksin 2 drejt



Raportit të VSMJ është dhënë një pasqyrë e shkurtër e analizës shtesë dhe korelacioni i qëllimeve të PRMM me qëllimet e planeve, programeve dhe strategjive të tjera kombëtare, qëllimet e Direktivave të BE-së, si dhe obligimet që dalin nga konventat relevante ndërkombëtare.

#### 1.4 Aspektet relevante të gjendjes aktuale të mjedisit jetësor

Aspektet relevante të gjendjes aktuale të mjedisit jetësor të ndërlidhura me popullatën dhe shëndetin e njerëzve, karakteristikat klimatike dhe cilësinë e ajrit, ujit, tokës, biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore, trashëgimisë kulturore dhe të mirave materiale janë detajisht të përshkruara në kapitullin 4 të Raportit të VSMJ-së.

Në këtë pjesë është e rëndësishme që të theksohet se pjesa verilindore e përfshinë pjesën e fundit verilindore të Republikës së Maqedonisë. Ky është njëri prej rajoneve më të vogla në Republikën e Maqedonisë, ndërsa në kuptim administrativ rajoni verilindor përbëhet nga komunat: e Kumanovës, Likovës, Nagoriçanit të Vjetër, Rankovcës, Kratovës dhe Kriva Pallankës. Përfshinë sipërfaqe prej 2310 km<sup>2</sup>, që paraqet 9,3% nga territori i Republikës së Maqedonisë. Në rajonin verilindor të planit jetojnë 172 787 banorë.

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave në komunat e rajonit verilindor është themeluar, kryesisht, në grumbullimin dhe mënjanimin e mbeturinave. Në rajon ka 5 deponi komunale: edhe ate në komunën e Kratovës, Kriva Pallankës, Kumanovës, Likovës dhe Rankovcës. Komuna e Nagoriçanit të Vjetër i deponon mbeturinat në deponinë e Komunës së Kumanovës. Deponitë në Kriva Pallankë („Gorna Luka“), Rankovcë („Çombardino“) dhe në Kumanovë („Krasta“) janë kontrolluar; ndërsa deponia në Likovë („Buçik“) është e pakontrolluar, mirëpo deponia në Komunën e Kratovës („Meçkin Doll“) shfrytëzohet jashta procedurës administrative. Rajoni verilindor është njëri ndër rajonet me një numër më të vogël të deponive aktive dhe me sipërfaqe më të vogël shfrytëzuese.

Lloji dominues i deponimit të mbeturinave që është vërejtur përfshinë: mbeturinën e fortë komunale, mbeturinën e kafshëve, mbeturinën e kopshtit, mbeturinën e ndërtimit. Sipas hulumtimit të zbatuar tenderial, ekzistojnë 36 deponi të egra të pakontrolluara, sidomos në sferat rurale.

Sipas pyetësorit të mbeturinave, komuna më e populluar është komuna e Kumanovës dhe e njëta përfshinë 70% të prodhimit të përgjithshëm të mbeturinave në rajonin verilindor. Thjesht komunat rurale d.m.th. Rankovca, Likova dhe Nagoriçani i Vjetër kanë, kryesisht prodhim më të vogël të mbeturinave se sa mjedise urbane, që të çon deri në një pjesëmarrje të vogël në prodhimin e mbeturinave në nivel rajonal.

Shërbimin e grumbullimit, transportimit dhe mënjimit të mbeturinave e sigurojnë Ndërmarrjet Publike Komunale (NPK), me përjashtim të Komunës së Kratovës, e cila ka lidhur marrëveshje me Ndërmarrjen Private “Sillkom”. Por, likuiditeti i pamjaftueshëm i NPK-së mundëson investim në infrastrukturën përkatëse për separimin dhe trajtimin e mbeturinave, prandaj në pjesën më të madhe grumbullohet mbeturina e kombinuar dhe e njëta mënjanohet në deponit komunale, që nuk janë në pajtim me standardet e BE-së.





## 1.5 Karakteristikat e mjedisit jetësor të rajonit që do të jetë i tanguar në mënyrë të rëndësishme dhe gjendja e mungesës së realizimit të planit

Në këtë kapitull janë përshkruar problemet karakteristike/ekologjike në këtë rajon, çështjet kyçe ose problemet relevante për sistemin ekzistues të menaxhimit me mbeturinat në këtë rajon dhe vlerësimi i mjedisit jetësor pa zbatimin e PRMM, në lidhje me popullatën dhe shëndetin e njerëzve, karakteristikat klimatike dhe cilësia e ajrit, ujit, tokës biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore, trashëgimisë kulturore dhe të mirave materiale.

Sistemi i aktual për menaxhimin e mbeturinave në rajon kryesisht, është themeluar, në grumbullimin dhe mënjanimin e mbeturinave. Një pjesë e madhe e popullatës që jeton në mjediset rurale në përgjithësi nuk marrin shërbime për grumbullimin e mbeturinave. Mbeturina nuk trajtohet para deponimit. Mbeturina industriale, e ndërtimtarisë, bujqësore, madje edhe mbeturina e rrezikshme shpesh deponohen së bashku me mbeturinën komunale pa trajtim paraprak.

Deponit komunale, edhe pse janë të organizuara, nuk janë në pajtim me kërkesat e BE-së. Krahas kësaj, ka një numër të madh të deponive të pakontrolluara të egra, që paraqesin një rrezik të madh për mjedisin jetësor.

Vlerësimi i zbatuar i lokacioneve të deponive në këtë rajon tregon se ato mbajnë rrezik për shëndetin e njerëzve, ujit, tokës ( sipërfaqësore, nëntokësore), biodiversitetit etj. Shumica prej tyre janë vlerësuar si me rrezik të lartë ose të mesëm. Vlerësimi mjedisit jetësor pa zbatimin e PRMM tregon se do të vazhdojnë trendet dhe kërcënimet e mëposhtme që kanë të bëjnë me sistemin ekzistues të menaxhimit të mbeturinave;

- menaxhimin e paqëndrueshëm të mbeturinave
- menaxhimin e mbeturinave që nuk është në përputhje me Direktivat e BE-së;
- grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave në mënyrë të paligjshme,
- deponimin e paligjshëm,
- deponimin e mbeturinave të ndryshme në deponit pa trajtim paraprak,
- mbeturina biodegradable përfundon në deponi dhe gjeneron emisione të rëndësishme në ajër,
- djegien e mbeturinave në hapësirë të hapur në deponit (legale ose ilegale),
- emisionet nga gazi i deponisë,
- aromën e pakëndshme (gjatë grumbullimit, transportit dhe deponimit),
- rritjen e emisioneve të gazeve serë,
- krijimin e filtrit dhe depërtimit të tij në organet e ujit dhe tokës pa asnjë lloj trajtimi,
- përfshirjen e sipërfaqes së madhe të tokë për deponimin e mbeturinave,
- lokacionet jo-sanuese të deponive me një rrezik të madh për mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve,
- një ndikimi të rëndësishëm të mediave të mjedisit jetësor (emisione të rritura të ajrit, zhurmës, aromës së pakëndshme, ndotjes së tokës dhe ujërave) dhe efektit ndaj cilësisë e jetës të shkaktuar nga sistemi aktual i menaxhimit me mbeturinat,
- gjendjen e dobët të shëndetit lidhur me cilësinë e mjedisit jetësor,
- sëmundjen, si rezultat i infeksioneve që transmetohen përmes ushqimit, ujit, ajrit, tokës, etj.



- normën e reduktuar të punësimit, të ardhurave të reduktuara nga riciklimi dhe shfrytëzimi i mbeturinave etj.
- të ardhurave të kufizuara nga riciklimi i shfrytëzimit të mbeturinave etj.

## 1.6 Rajonet prej një rëndësie të veçantë nga aspekti i mbrojtjes së zogjve të egër dhe të habitateve

Rajoni verilindor karakterizohet me:

**Katër rajone të rëndësishme për zogjtë:** Pçinjë-Petroshnicë-Kriva Rekë, Malet e Osogovës, Proed-Gjurgjanceë dhe lugina e Lumit Zletovcë.

**Rajone të rëndësishme bimore:** RRB Malet e Osogovës, RRB Ovçe Pole-Bogoslovec, RRP Mali i Zi i Shkupit.

**Lokalitetit emerald:** Pçinjë-German, Osogovë.

## Qëllimet e mbrojtjes së mjedisit jetësor të përcaktuara në nivel ndërkombëtar dhe ndërkombëtar

Qëllimet e mbrojtjes së mjedisit jetësor janë definuar në pajtim me legjislativën kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të njëjtat u marrën para sysh gjatë përpunimit të Raportit të VSMJ. Në këtë Raport janë definuar qëllimet e përgjithshme të ndërlidhura me vendosjen e sistemit funksional efikas kombëtar me mjedisin jetësor.

Qëllimet e veçanta të mbrojtjes së mjedisit jetësor, të shprehura përmes qëllimeve të VSMJ, janë:

- Përmirësimi i kushteve të jetës së popullatës,
- Mbrojtja dhe avancimi i biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore,
- Mbrojtja dhe avancimi i cilësisë së ujit,
- Mbrojtja dhe avancimi i cilësisë, kuantitetit dhe funksionit të tokës,
- Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe reduktimi i emisioneve të gazrave serë,
- Përmirësimi dhe mbrojtja e të mirave materiale,
- Mbrojtja dhe avancimi i trashëgimisë kulturore,
- Rruajtja e karakteristikave të peisazhit dhe mbrojtja e peisazhit kudo, sidomos në zonat e shpallura.

Lidhshmëria e qëllimeve dhe e Planit të VSMJ përshkruhen më detajisht në kapitullin 7.1.

## 1.7 Analiza e alternativave

Në bazë të vlerësimit dhe llogaritjeve të detajuara, plotësisht të mbështetura me metodën ELECTRE III për rajonin verilindor në PRMM si më përkatëse për menaxhimin e qëndueshëm me mbeturinat, të rregulluara në mënyrën e rekomanduar që vijon: Skenari C3b (më i rekomanduar), Skenari C2 (i dyti) dhe Skenari C1a (I treti).

Që të fitohet një pasqyrë e qartë e ndikimeve potenciale ndaj mjedisit jetësor e cila mund të paraqiten gjtë realizimit të skenarit C3b, C2, C1a, në këtë kapitull bëhet krahasimi midis „skenarit pa ndonjë ndryshim“ (sistemin aktual i menaxhimit me mbeturinat në rajon) dhe zbatimit të skenarëve të propozuara.



Që të verifikuar nëse skenari më i mirë i propozuar në PRMM (C3b) dhe në të njëjtën kohë është edhe skenar më i mirë në aspektin e vlerësimit strategjik të mjedisit jetësor, në Raportin e VSMJ bëhet një krahasim në mes opsioneve të skenarëve propozuara.

**Përfundimi:** Nga skenarët e propozuar, mund të vijmë në përfundim se skenari C3b jep një përfundim më të madh dhe ka ndikime më të vogla mbi mjedisin jetësor në krahasim me skenarët tjerë. Kryesisht, të gjitha opsionet në këto skenarë janë të ngjashëm, gjenerojnë ndikime të ngjashme dhe përfshijnë teknologji të ngjashme për trajtimin e mbeturinave. Dallimet janë vetëm në llojin e trajtimit mekanik (kapacitete të pastra dhe të pa-pastra për përdorimin e materialit), kompostimit të mbeturinave organike dhe të gjelbëra dhe cilësinë e materialit të ricikluar të prodhuar.

Sistemi në dy kova për mbledhjen e mbeturinave të paraqitura në skenar S3b, kapacitetet e pastra për përdorimin e materialeve dhe kompostimit shtëpiak ofrojnë avantazhe me marrjen e një produkti me cilësi dhe ndikim të ulët mbi mjedisin jetësor se sa në skenarët tjerë.

Mund të vijmë në përfundim se, krahas këtij vlerësimi, skenari C3b propozohet si një skenar i rekomanduar në PRMM. Ky pozicion tregon rezultate më të mira në përputhje me kriteret ligjore, ekologjike, teknologjike dhe ekonomike.

## 1.8 Ndikimet e mundshme të rëndësishme në mjedisin jetësor

PRMM paraqet një bazë për zbatimin e sistemit të integruar për menaxhimin me mbeturinat si një mënyrë e kontrollimit të llojeve të ndryshme të mbeturinës së krijuar.

PRMM do të parqes një udhëzim për menaxhimin e ardhshëm të mbeturinave në rajon dhe do të kontribuojë drejt reduktimit të sasisë së mbeturinave që përfundojnë në deponi, vëllimin e rrezikshmërisë potenciale të mbeturinës së krijuar, emisioneve në atmosferë, ujit dhe tokës, emisionet e gazrave serë dhe materiet tjera ndotëse që gjenerojnë me sistemin ekzistues të menaxhimit me mbeturinat.

Krahas përfitimeve të theksuara, menaxhimi rajonal me mbeturinta do të kontribuojë drejt përmirësimit të gjendjes socio-ekonomike në këtë rajon, që do të reflektohet përmes ofertës së rritur të vendeve të punës, klimës së mirë afariste, etj.

Pavarësisht nga fakti se skenari i rekomanduar (C3b) do të kontribuojë drejtë vendosjes së ardhshme të sistemit të rregullt të menaxhimit me mbeturinat dhe drejt përmirësimit të situatës aktuale të menaxhimit të mbeturinave, zbatimi i opsioneve të përpunuara përmes projekteve të veçanta mund të shkaktojë edhe efekte negative në nivelin lokal.

Pavarësisht vlerësimit të ndikimeve të mjedisit jetësor nga skenari i rekomanduar C3b, në këtë kapitull është përfshirë edhe vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor i shkakuar nga rikuperimi i parregullt / deponive ilegale në rajon, si pjesë e aktiviteteve të PRMM.

Skenari i rekomanduar C3b dhe rindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta/të egra i përmban opsionet dhe nënopsionet e mëposhtme:

**Tabela 1 Skenari 3b dhe rindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta/të egra**

Skenari 3b dhe ripërtirja e deponive ekzistuese të parregullta/të egra	
<b>Opsioni: Parandalimi i mbeturinave</b>	<b>Nënopsioni:</b> Aktivitetet për ngritjen e vetëdijes së publikut për parandalimin e mbeturinave, financimin dhe zbatimin e projekteve dhe shërbimeve në bazë të ripërdorimit në rajon, mbështetja dhe aftësimi i bashkësisë dhe sektori vullnetar, dmth bankat për ushqim, ushqim për kafshët dhe iniciativat për të varfërit, përpunimin e udhëzime të ndryshme për parandalimin e mbeturinave, hulumtimin dhe zhvillimin



<b>Opsioni: Grumbullimi</b>	<b>Nënopsioni:</b> Sistemi për mbledhje në dy kova (kova për mbeturina që mund të riciklohen dhe kova për mbeturinat tjera), pika të gjelbëra, grumbullimi i ndarë i mbeturinave të gjelbëra
<b>Opsioni: Kova për trajtimin e mbeturinave që mund të riciklohet</b>	<b>Nënopsioni:</b> Kapaciteti për përdorimin e materialeve (KPM)
<b>Opsioni: Kova për trajtimin e mbeturinave tjera</b>	<b>Nënopsioni:</b> Stabilizimi mekanik dhe biologjik (SMB)
<b>Opsioni: Trajtimi i mbeturinave të gjelbëra</b>	<b>Nënopsioni:</b> Kompostimi në brazda – kompostimi në hapësirë të hapur
<b>Opsioni: Trajtimi i burimit</b>	<b>Nënopsioni:</b> kompostimi shtëpiak
<b>Opsioni: Deponija</b>	<b>Nënopsioni:</b> deponia e mbeturinave tjera
<b>Opsioni: Sanimi i deponive ekzistuese të parregullta/ të egra</b>	<b>Nënopsioni:</b> Rindërtimi i deponisë – Modeli „A” – Deponimi i mbeturinës me metodën „ex-situ” <sup>2</sup> , Rindërtimi i deponisë – Modeli „B” Deponim i siguar „in-situ” <sup>3</sup> , Rindërtimi i deponisë – Modeli „C” – Deponim i siguar „in-situ” <sup>4</sup>

**Tabela 2 Ndikimet e mundshme pozitive të shkaktuara nga realizimi i skenarit të rekomanduar C3b dhe rindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta / të egra**

<b>Skenari 3b dhe rindërtimi deponive ekzistuese të parregullta / të egra</b>	
<b>Qëllimet e VSMJ</b>	<b>Vlerësimi i ndikimit që do ta shkaktojnë opsionet</b>
<b>Përmirësimi i kushteve për jetesës së popullatës</b>	<p><b><u>Parandalimi i mbeturinave</u></b><sup>5</sup></p> <p>Ky opsion është i mjaftueshëm për menaxhimin me mbeturinat, i vendosur në krye të hierarkisë së menaxhimit me mbeturinat. Përfitimet kryesore të këtij opsioni janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Qëndrueshmëria e përmirësuar duke reduktuar nevojën për prodhimin primar të resurseve;</li> <li>- Sigurimi për përdorimin më të mirë të materialeve dhe reduktimi i nevojës për deponitë;</li> <li>-Prolongimi i jetës së produkteve;</li> <li>- Bankat për ushqim sigurojnë një ndihmë të drejtpërdrejtë njerëzve që gjinden në krizë;</li> <li>-Eliminohet nevoja për grumbullimin, përpunimin/trajtimin dhe deponimin e mbeturinave dhe ndikimet e ndërlidhura negative mbi mjedisin jetësor si rezultat i këtyre aktiviteteve;</li> <li>-Nuk ka ndikim negativ të mjedisit jetësor dhe shëndetit të njerëzve;</li> <li>-Ka një neto përfitim për mjedisin jetësor për secilin ton të mbeturinës së parandaluar për dallim nga çdo tjetër opsion i menaxhimit me mbeturinat.</li> </ul> <p><b><u>Grumbullimi i mbeturinave</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Menaxhimi i integruar me mbeturinat do të kontribuojë drejt ngritjes së vetëdijes së publikut për menaxhimin e zhvillueshëm me mbeturinat, ndërsa do të rezultojë me përmirësimin e mjedisit jetësor, shëndetit të njerëzve dhe me përfitime ekonomike.</li> <li>-Ndikimet potenciale pozitive janë: mundësitë për punësimin dhe grumbullimin e siguar të mbeturinave për trajtimin dhe deponimin.</li> <li>-Vendosja e grumbullimit ndaras, grumbullimi në dy kova, jep mundësi për shitjen e materialeve që mund të riciklohen dhe për reduktimin e sasisë së mbeturinës së deponuar.</li> <li>- Ndarja e fraksioneve të veçanta të mbeturinave komunale në burim jep rezultatete më të mira për riciklimin e materialeve të caktuara dhe jep mundësi për shitjen e produkte të cilësisë.</li> <li>-Mbledhja e ndarë e fraksionit të gjelbërt të pikave do të ketë ndikim pozitiv në mjedisin jetësor, ndërsa sipas kësaj dhe ndaj shëndetit të njerëzve. Gjithashtu, do të reduktoj</li> </ul>

<sup>2</sup> „Ex-situ” (jashta lokacionit) me pastrimin e mbeturinave dhe deponimit të tyre të sërishëm të deponisë komunale. Kjo metodë është e zbatueshme për sanimin e deponive jolegale të vogla (të egra) me sasi deri në 1,000 m<sup>3</sup>.

<sup>3</sup> Është propozuar për sanim të deponive me rrezik minimal dhe me rrezik shumë më të lartë dhe një sasi të konsiderueshme të mbeturinave deponuese deri me 100,000 m<sup>3</sup> me afat të mesëm.

<sup>4</sup> Propozohet për deponitë me shumë rrezik të madh dhe sipërfaqe të rëndësishme të mbeturinës së deponuar (prej 100,000 deri 500,000 m<sup>3</sup>) me afat të shkurtër.

<sup>5</sup> Ndikimet pozitive janë të njëjta për të gjitha qëllimet e VSMJ-së



(incidentet) rreziqet shëndetësore dhe ato sigurorese në nivel profesional dhe në nivel të amëvisrisë.

-Mbledhja e ndarë e mbeturinës së gjelbërt kontibuon që të fitohet një kompost (përzjerje) me një cilësi sa më të mire, reduktimin e gazrave të deponisë dhe gazeve serë. Të gjitha opsionet e theksuara për mbledhjen e ndarë të mbeturinës komunale do të kenë efekte të rëndësishme pozitive ndaj ndryshimeve klimatike dhe ndikimit të tyre negativ të shëndetit të njerëzve.

**Pikat e gjelbëra dhe stacionet mbingarkese**—mund të përdoren si sipërfaqe punuese për riciklimin. Përfitimet kryesore nga sipërfaqet për riciklimin janë diversioni dhe përdorimi i rrjedhave të veçanta të mbeturinave, të cilat edhe pse mund të deponohen në deponitë e regullta. Me këtë opsion do të reduktohet ndikimi ndaj shëndetit, ndërsa në të njëjtën kohë sipërfaqet për riciklim mund të kontribuojnë në edukimin e qytetarëve për menaxhimin me rrjedhat e lartpërmendura të mbeturinave.

Ky opsion do të sigurojë efekte të punës dhe efekte ekonomike (vende të drejtpërdrejta punuese lidhur me kapacitetin e mbeturinave dhe vende indirekte të punës për personat në nivel lokal dhe rajonal, stimulimin e ekonomisë më të gjerë dhe krijimin e firmave të reja që lidhen me menaxhimin e mbeturinave, p.sh.: kapacitete për riciklimin dhe ripërdorimin).

Gjithashtu, stacionet e transferimit do të kontribuojnë në uljen e harxhimeve të transportit të mbeturinave të kapaciteteve për deponimin, shpenzimin e karburantit, shkaktimin e shpesht të trafikut, emisionet në ajër, etj.

#### **Transporti**

Ndikimet e mundshme pozitive shëndetësore që lidhen me transportin e mbeturinave janë: punësimi dhe transporti i mbeturinave për deponimin e sigurt.

#### **Trajtimi i kovës së mbeturinave që mund të riciklohet (KPM)**

Ndikimet e mundshme pozitive: vazhdohet afati i prodhimeve, sigurohet materiali i përpunuar për përdorim, përmirësohet qëndrueshmëria e reduktimit të nevojës për prodhimin primar të resurseve, reduktohen sasitë për deponim dhe reduktohen harxhimet për mbrojtjen e mjedisit jetësor nga aspekti i energjisë dhe emisioneve, reduktohet në minimum përdorimi i lëndëve të para të reja dhe përpunimi i këtyre materialeve, realizohen kursime e emisioneve të CO<sub>2</sub> nga konsumi i energjisë.

Ndarja e materialeve që mund të riciklohen në KPM të pastra do të sigurojë efekte pozitive për shëndetin, punësimin dhe për ekonominë. Kjo mund të shqyrtohet nëpërmjet krijimit të vendeve të punës të drejtpërdrejta lidhur me kapacitetet e mbeturinave dhe vendeve të punës indirekte për njerëzit në nivel lokal dhe rajonal, përmes stimulimit ekonomisë më të gjerë.

#### **Stabilizimi mekanik dhe biologjik (SMB)**

Trajtimi i mbeturinave tjera në SMB do të sigurojë materiale të vlefshme që mund të riciklohen dhe të mund të shitet si kompost, Fe, Al dhe jometale të tjera që mund të riciklohen. Procesi i SMB mund të prodhojë lëndë djegëse kalorike të larta të forta SRF mund të përdoret në centralet energjetike apo furrat e çimentos.

SMB do të ketë efekt pozitiv ndaj shëndetit të njerëzve, efekte përmes punësimit dhe efekte ekonomike në nivel rajonal.

#### **Kompostimi i brazdës – kompostimi në hapësirë të hapur**

Ndikimet e mundshme pozitive të trajtimit të mbeturinës së gjelbër me kompostim në brazda përfshijnë prodhimin e kompostit me cilësi të mirë, i cili do ta stimulojë ekonominë më të gjerë nëpërmjet mbulimit të lëndëve që mund të riciklohen (komposti si revitalizues i tokës).

#### **Kompostimi shtëpiak**

Ndikimet e mundshme pozitive të kompostimit shtëpiak:

-Trajtimi i mbeturinave organike në zonat rurale dhe prodhimi i kompostit me një cilësi të mire;

- Përfitimet financiare për prodhuesit individual të kompostit.



	<p><b>Deponi për mbeturinat tjetra</b></p> <p>Edhe pse deponimi i mbeturinave është opsioni më pak i dëshiruar, ai ende është pjesë e një sistemi të integruar për menaxhimin e mbeturinave. Ndikimet e mundshme kryesore pozitive të deponisë së ardhshme rajonale janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-deponim i reduktuar ose i eliminuar në deponitë e egra ose në ato të parregullta në këtë rajon edhe në ndikimet negative ndaj mjedisit jetësor dhe shëndetit të njerëzve të shkaktuara me këtë,</li> <li>-deponim i rregullt dhe i sigurt në mbeturinën e mbetur të deponisë përkatëse,</li> <li>-prodhim i mundshëm i energjisë të gazit të deponisë nga djegia,</li> <li>-punësimi.</li> </ul> <p><b>Rindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta/të egra</b></p> <p>Ndikimet e mundshme pozitive nga rehabilitimi i deponive ekzistuese të parregullta/të egra:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- reduktimi dhe eliminimi i ndotjes së mjedisit jetësor dhe shëndetit të njeriut të shkaktuara nga deponitë ekzistuese;</li> <li>-ekziston mundësia që lokacionet e ardhshme rehabilituese të përdoren për aktivitete tjera, si parqe, shesh lojrash etj, që do të shkatraj ndikime pozitive sociale.</li> </ul>
<p><i>Mbrojtja dhe avancimi i biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore</i></p>	<p>Të gjitha opsionet do të kontribuojnë për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave dhe do të sigurojnë rezultate më të mira në riciklimin dhe ripërdorimin e materialeve të caktuara, me çka do të reduktohet nevoja nga kapaciteti i madh i deponisë së re dhe ndikimit të biodiversitetit. Riciklimi dhe ripërdorimi i materialeve të mbeturinave paraqet një pikë fillestare të shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve dhe kontribuon për kërkesën e reduktuar të materialeve natyrore (eksplotimi i materialeve natyrore shkakton dëm të pa vlefshëm të biodiversitetit).</p> <p>Rindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta/të egra dhe deponia rajonale do t’na çojnë deri te ndikimet pozitive të biodiversitetit në nivel rajonal, sepse deponimi aktual jolegal i mbeturinave dhe palimi i tyre në deponitë e parregullta në komunat që shkaktojnë dëm të florës, faunës, vendbanimeve etj, do të mënjanohej. Në disa pjesë të rajonit, gjendja e biodiversitetit vlerësohet si një rrezik i lartë.</p>
<p><i>Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ujërave</i></p>	<p>Mbledhja e veçantë dhe e organizuar e rrjedhave të ndryshme të mbeturinave për trajtimin e mëtejshëm dhe opsionin e propozuar për trajtimin e mbeturinave është pjesë e opsionit për një menaxhim të qëndrueshëm dhe të integruar të mbeturinave dhe japin kontribut në uljen e ndotjes direkte dhe indirekte të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.</p> <p>Rindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta / të egra dhe deponia rajonale do të çojnë në ndikime pozitive në resurset ujore duke pasur para sysh faktit se në të ardhmen do të braktisen praktikatat e deponimit të mbeturinave të deponive të parregullta dhe të egra. Në disa pjesë të rajonit, statusi i organeve të ujit është vlerësuar si një rrezik i lartë.</p>
<p><i>Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë, kuantitetit dhe funksionit të tokës</i></p>	<p>Riciklimi dhe ripërdorimi i mbeturinave janë pjesë të opsionit për menaxhim të qëndrueshëm dhe të integruar të mbeturinave dhe japin kontribut në uljen e ndotjes direkte dhe indirekte të tokave.</p> <p>Këto opsione ofrojnë mundësi për riciklimin dhe ripërdorimin e materialeve të caktuara, me çka do të reduktohet kapaciteti i deponisë dhe do të shkaktohen ndikime pozitive ndaj tokës dhe përdorimit të tokës.</p> <p>Rindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta / të egra dhe deponia rajonale do të çojnë në ndikime pozitive në tokës, si rezultat i faktit se deponitë ekzistuese të egra dhe deponitë komunale do të mbyllen, sanohen dhe do të përdoren për qëllime të tjera. Në disa pjesë të rajonit, statusi i tokës është vlerësuar si një rrezik i lartë.</p>
<p><i>Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe reduktimi i emisioneve të gazrave serë</i></p>	<p>Opsionet e riciklimit dhe ripërdorimit të mbeturinave kontribuojnë në reduktimin e emisioneve të gazrave serrë nga deponia dhe mund të përfaqësojnë kompensim për energjinën dhe emisionet e karbonit që lidhen me nxjerrjen dhe prodhimin e materialeve natyrore.</p> <p>Më tej, opsionet ofrojnë mundësinë për t’iu shmangur deponimit jolegal të mbeturinave dhe djegies së tyre, me çka do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit.</p>



	<p>Me zbatimin e opsioneve për kompostimin e brezdave – kompostimin në hapësirë të hapur, sasia e mbeturinës së gjelbër që përfundon në deponi dhe shkakton emisione të gazrave serë (si shkaktues më të mëdhej të ndryshimeve klimatike), do të zvogëlohen.</p> <p>Rindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta/të egra do të sjellë në një përfitim përmes eliminimit të deponimit ekzistues jolegal të mbeturinave, që shkakton ndotje të rëndësishme të ajërimit dhe paraqet rreziqe shëndetësore për njerëzit.</p> <p>gjithashtu, rindërtimi i deponisë rajonale dhe prodhimit potencial të energjisë nga gaz i deponisë nga djegia do të çojë në reduktimin e emisioneve të gazrave serë në nivel rajonal dhe lokal.</p>
<i>Përmirësimi dhe mbrojtja e të mirave materiale</i>	Opsionet japin mundësi për përdorimin e mëtejshëm të materialeve dhe reduktimin e mbeturinave deponuese, që kontribuon për energji të reduktuar të konsumit, ujit, materiale natyrore etj .
<i>Mbrojtja dhe avancimi i trashëgimisë kulturore</i>	Opsionet do të kontribuojnë në reduktimin ose eliminimin e deponisë jolegale, me çka do të shmanget ose do të reduktohet në minimum ndikimi i mundshëm ndaj trashëgimisë kulturore dhe ndaj zonave të rëndësishme turistike në rajon.
<i>Rruajtja e karakteristikave të peizazhit dhe mbrojtja e peizazhit kudo, ndërsa në veçanti në zonat e mbrojtura</i>	<p>Me këto opsione do të zvogëlohet nevoja për deponimin jolegal apo nevojën për kapacitetin e lartë / sipërfaqen për deponin e ri. Me këtë do të shmangen ose do të reduktohen në minimum ndikimet potenciale ndaj peizazhit dhe trashëgimisë natyrore.</p> <p>Rindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta komunale do të ketë një ndikim pozitiv në peizazhin e rajonit, sepse deponitë e egra/ të parregullta komunale që shkaktojnë ndikime negative në rajon, si pasojë e djegies së mbeturinave, mbeturinave të lëngshme etj., do të pastrohen dhe do të rehabilitohen.</p> <p>gjithashtu, ekziston mundësia që lokacionet e ardhshme të ripërtitshme të shfrytëzohen për aktivitete tjera, si parqe, sheshe lojrash etj).</p>

**Tabela 3** Ndikimet e mundshme negative të shkaktuara nga realizimi i skenarit të propozuar C3b dhe rindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta /të egra

<b>Skenari C3b dhe Rindërtimi deponive ekzistuese të parregullta /të egra</b>	
<b>Qëllimet e VSMJ</b>	<b>Vlerësimi i ndikimit që do ta shkaktojë opsionet</b>
<i>Përmirësimi i kushteve të jetës së popullatës</i>	<p><u>Ndikimi ndaj shëndetit</u></p> <p>Ndikimet e mundshme negative të shkaktuara gjatë grumbullimit dhe transportit të mbeturinave dhe kapaciteteve për menaxhimin me mbeturinat janë të ndërlidhura me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-pluhurin, bio aerosolin, emisionet nga komunikacioni, gazrat e deponisë dhe gazrat e bymuar nga djegia e gazit të deponisë, aroma e pakëndshme, bakteriet dhe dëmtuesit, insektet, shqetësimi me anë të zhurmës, mund të shkaktojnë ndikim negativ ndaj cilësisë së ajërimit,</li> <li>-Kontributi drejt ndryshimeve klimatike përmes gjenerimit të gazrave serë nga aktivitete të ndryshme,</li> <li>-Filtrat, uji i ndotur dhe uji i ndotur atmosferik, rrjedhje incidentale e trajtimit jo përkatës mund të çojnë deri te ndotja e ujërave dhe e tokës,</li> <li>-Ndikimi vizuel,</li> <li>-Zjarri dhe eksplozivi,</li> <li>-Komunikacioni i ngarkuar rrugor dhe ngarkimi i të njetit me aksidente të mundshme të komunikacionit,</li> <li>-efekte ndaj shëndetit mental, përmes planifikimit dhe vendosjes së kapaciteteve për mbeturinat në afërsi të pjesës rezidenciale,</li> <li>-Nëse nuk zbatohen masat përkatëse siguroese në kapacitetet për menaxhimin me mbeturinat, priten pasoja negative për shëndetin dhe sigurinë nga vizitorët e paautorizuar (grumbullues ilegal të mbeturinave, kullosja e kafshëve etj).</li> <li>-Kompost nga mbeturinat e gjelbëra mund të përmbajnë një numër i kontaminuar organik (pesticidet, prodhimet farmaceutike, ndotësit industrial), që kanë potencial të kontribuojnë në kontaminimin e zinxhirit të ushqimit dhe të kenë ndikim negativ të</li> </ul>



	<p>kafshëve shtëpiake që kullosin.</p> <p>-Komposti i prodhuar (CLO) nga SMB (bio stabilizim) ka një cilësi të ulët dhe mund të përdoret si një matetial për mbullimin e deponisë ose për restaurimin e tokës. Nëse në këtë kompost shfrytëzohet vetëm mbeturina, ka një potencial që ta kontaminojë zinxhirin e ushqimit ose të shkaktojë ndikim negativ të kafshëve shtëpiake që kullosin.</p> <p>Të gjitha ndikimet që u theksuan më lartë të shëndetit të njerëzve do të varen nga sistemi i grumbullimit të organizuar të mbeturinave dhe të masave të zbatuara, llojit të vjetërsisë së automjeteve për transport, rrugët për transport, mbledhjen e shpeshhtë, skladingun në kohë të mbeturinave në vendin grumbullues, si dhe zgjidhjen e lokacionit për vendosjen e kapaciteteve për menaxhimin me mbeturinat dhe ndjeshmërinë e tyre, zbatimin e masave adekuate dhe qëndrueshmëria e proceseve të kapaciteteve.</p> <p><u>Aspektet socio-ekonomike</u></p> <p>Ndikimet e mundshme negative nga aspekti socio-ekonomik (të shkaktuara nga grumbullimi dhe transporti i mbeturinave dhe nga kapacitetet për menaxhimin me mbeturinat) ndërlidhen me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Tarrifën e rritur të mbeturinave që mund të shkaktoj ndikim negativ financiar të sektorit komercial dhe amvisisë.</li> <li>-grupet e ndjeshme– penzionerët, bujqit që jetojnë në kufirin e varfërisë.</li> <li>- sistemin e ri për menaxhimin e mbeturinave që do të ket ndikim negativ social të sektorit joformal.</li> <li>-shfrytëzimin e tokës në korelacion me ndërtimin e kapaciteteve për menaxhimin me mbeturinat dhe infrastrukturën shoqëruese – ka mundësi që disa prej objekteve të ndërtohen në tokën private, që mund të shkaktoj ndikime negative për pronarët e parcelave.</li> <li>- Konvertimin e tokës bujqësore për qëllim urban. Ky veprim mund të ketë efekte negative në karakteristikat funksionale të tokës.</li> <li>-Ripërtrirjen e deponive ekzistuese (të parregullta / të egra) që mund ti shkaktojnë ndikimet e lartëpërmendura për shëndetin e njeriut. Pritet që shkalla më intensive e këtyre ndikimeve do të paraqitet gjatë ndërtimit, por gjenerimi i gazit të deponisë dhe filtrat do të vazhdojnë pas rindërtimit.Ndikimi i mundshëm i këtyre aktiviteteve do të analizohet në detaje në nivel të projektit.</li> </ul>
<p><i>Mbrojtja dhe avancimi i biodiversitetit dhe trashigimisë natyrore</i></p>	<p>Opcioni i skenarit të rekomanduar për menaxhimin e mbeturinave në rajon mund të ketë ndikime negative në biodiversitetin si rezultat i emisioneve të rritura të pluhurit dhe materjeve të tjera ndotëse, zhurmës, ndotjes së ujit dhe tokës, rritjes së trafikut në lokacionin e zgjedhur ku do të vëhen kapacitetet për menaxhimin me mbeturinat dhe rrethi i tyre përgjatë rrugës së transportit.</p> <p>Ndikimi ndaj biodiversitetit do të mvaret nga zbatimi i teknikave më të mira në dispozicion për të gjitha opsionet, masat e zbatuara për zvogëlimin ose reduktimin në minimum të ndikimit ndaj cilësisë së ajrit, ujërave dhe tokës dhe ndjeshmërinë e lokacionit të zgjedhur. Nuk pritët që opsionet nga skenari i preferuar të shkaktojnë ndikime direkte negative ndaj trashëgimisë natyrore, për shkak të kriterëve për selektimin e komunikacionit të përmbajtur në PRMM (instalimi i kapaciteteve për menaxhimin me mbeturinën e fortë që të mënjanohet në kuadër të rajoneve në vijim: zonat e mbrojtura me ligj dhe elementet individuale të natyrës dhe peisazhit: Natyra 2000, parqet kombëtare, lokalitete sipas Marrëveshjes së Ramsarit, etj.).</p> <p>Komposti i prodhuar (CLO) nga kapacitetet për SMB (biostabilizues) mund të shfrytëzohet si material për mbullimin e deponisë. Nëse ky kompost shfrytëzohet si plehër, mund të shkaktojë ndikim negativ të sipërfaqeve për rreth (biodiversitetit të ujit, kafshëve që kullosin etj).</p> <p>Nuk pritët rindërtimi i deponive ekzistuese (të parregullta/ të egra) të ndikojnë në biodiversitetin në fazës së rindërtimit. Ndikime të mundshme negative mund të paraqiten gjatë aktiviteteve të ndërtimit, por ato nuk vlerësohen plotësisht në nivel të projektit .</p>
<p><i>Mbrojtja dhe përmirësimi i</i></p>	<p>Të gjitha opsionet (dhe masat dhe aksionet pasuese) në skenarin e propozuar (C3b) për menaxhimin rajonal me mbeturinat mund të ken ndikim negativ ndaj resurseve ujore në</p>





<p><i>cilësisë së ujit</i></p>	<p>rast të zgjidhjes së paregullt të lokacionit për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin me mbeturinat, për rrjedhjen potenciale, filtër i lëshuar i patrajtuar, dhe lëshimi i ujërave të ndotura , etj.</p> <p>Aspekti pozitiv është fakti që PRMM i përjashton lokacionet në kufijt e rajoneve të ndjeshme të pellgut të ujit (ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore) për vendosjen e kapaciteteve për menaxhimin me mbeturinat.</p> <p><b><u>Grumbullimi i transportit</u></b></p> <p>Aktivitetet për grumbullimin, transportin dhe skladimin e mbeturinave (pikat e gjelbëra dhe stacionet mbingarkuese) mund të kenë ndikime të dëmshme të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si rezultat i rrjedhës dhe kullimit të rastësishëm, larja e automjeteve dhe pajisja e stërpikjes së hapësirës për skladimin, incidentet potenciale dhe kullimit gjatë transportit të mbeturinave. Natyra e efekteve do të varet nga karakteristikat e rajonit për grumbullimin, llojin e automjeteve, rrugëve transportuese dhe karakteristikave cilësore dhe kuantitative të rrjedhave të ujit.</p> <p><b><u>Kapacitetet mekanike dhe recikluese (KMR)</u></b></p> <p>Nuk priten ndikime më të rëndësishme ndaj trupave ujqor me zbatimin e KMC të pastra. Emisioni i vetëm i ujit nga KMC pritet nga balotazhi i hapësirës për parkim dhe nga larja e automjeteve dhe pajisjeve, si dhe rrjedhja e mundshme e parëndësishme për shkak të thyerjes/plasaritjes të kovave/cilindrave etj . Nëse ky ujë lëshohet pa trajtim paraprak, mund të shkaktoj ndotje të ujit.</p> <p><b><u>Stabilizimi mekanik dhe biologjik (SMB)</u></b></p> <p>Filtri i rastësishëm i lëshuar nga biostabilizimi/kompostimi mund të dedikoj rrezikshmëri potenciale për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Procesi i kompostimit ka nevojë të madhe nga lagështia, e cila përdoret në fazat fillestare të dekompozimit, dhe pastaj avullon në fazën e kompostimit. Kështu, që i gjithë filtri i prodhuar mund të përdoret brenda procesit.</p> <p>Filtri i lëshuar zakonisht përmban komponimet biodegradale (për shka se i njëjti ka një aromë të pakëndshme), nitratin dhe acidin organik. Ky lloj i ujërave të ndotura të patrajtuara mund të ketë një ndikim negativ të rrjedhave ujqore.</p> <p><b><u>Kompostimi i brazdës – kompostimi në hapësirë të hapur</u></b></p> <p>Ndikimi i burimeve të ujërave (sipërfaqësore dhe nëntokësore) nga instalimi për prodhimin e kompostimit është i lidhur me emisionin nga balotazhi nga sipërfaqja dhe filtrat nga kompostimi, si dhe nga larja e pajisjeve dhe automjeteve</p> <p>Filtri i kompostimit mund ti rrezikoj ujqrat sipërfaqësore dhe nëntokësore nëse lëshohen pa trajtim. Kompostimi i mbeturënës së gjelbër ka një potencial që të gjenerojë sasi më të mëdha të lëngëve të tepërta, nëse zbatohet në hapësirë të hapur. Madje edhe aktivitete mirë të menaxhuara të kompostimit prodhojnë sasi të vogla të filtrit.</p> <p><b><u>Deponia</u></b></p> <p>Deponia e planifikuar rajonale do të jetë moderne, me masa të zbatuara për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Përsëri, mund të paraqiten ndikime të caktuara të ndërlydhura me emisionet potenciale nga balotazhi i sipërfaqes dhe filtri i deponisë. Lëshimi i paqëllimshëm i filtrit nga deponia ose ujqrat e drenazhuar nga sipërfaqja e kontanimuar mund të kenë efekte të rëndësishme ndaj cilësisë së ujërave (sipërfaqësore dhe nëntokësore). Por, shkalla e këtij efekti do të varet nga karakteristikat hidrogeologjike të lokacionit, masave të zbatuara për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, fundrinën e instaluar të drenazhin, masat për mënjanim paraqitjeve të dukshme të aksidenteve dhe gjendjeve të jashtëzakonshme, vëllimin e intenzitetit të lëshimit, reduktimit të lëshimeve eventuale të kapacitetit hidrologjik dhe ekologjik të recipientit. Ky lloj i ndikimit do të dedikoj një rrezik afatgjatë në fazën e punës së deponimit dhe pas mbylljes së saj.</p> <p><b><u>Rindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta/të egra</u></b></p> <p>Rindërtimi i deponive ekzistuese mund të sfidoj ndikim negativ ndaj trupave ujqorë. Vëllim më inenziv i këtyre ndikimeve pritet në fazën e ndërtimit, por gjenerimi i filtrit do të</p>
--------------------------------	---



	<p>vazhdojë edhe sipas rripritrjes së tij; sipas kësaj nuk përjashtohet mundësia për ndikimin ndaj ujërave të shkaktuara nga modelet e propozuara</p> <p>Nuk pritet Modeli „A” i opsionit –deponimi i mbeturinës me metodën „ex-situ” të shkaktoj ndikime negative ndaj ujërave sipas fazës së rindërtimit, sepse lokacioni do të pastrohet, ndërsa mbeturina e mënjeluar do të deponohet në mbeturinat komunale.</p> <p>Modelet tjera për „in situ” rindërtimi mund të shkaktoj ndikime negative ndaj ujërave, duke pasur para sysh ate që krahas rindërtimit, mbeturina e deponuar do të vazhdojë që ti gjeneroj filtrat. Ndikimi i mundshëm negativ ndaj ujërave të shkaktuar nga filtri do të varet nga masat zbatuese për trajtimin e filtrit ndikimin i mundshëm i këtyre aktiviteteve do të analizohet më detajisht në nivel të projektit.</p>
<p><i>Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë, kuantitetit dhe funksionit të tokës</i></p>	<p>Opsionet e propozuara për menaxhimin me mbeturinat në këtë rajon mund të kenë ndikime të mundshme negative ndaj tokës në rastë të zgjidhjes së parregullt të lokacionit për ngritjen e kapacitetit për menaxhimin e mbeturinave, balotazhit potencial, filtrit të lëshuar të patrajtuar dhe ujit të ndotur etj. Por, duhet që të theksohet se në PRMM lidhen lokacionet me tokën karakteristike (të ndjeshme) për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave.</p> <p><b><u>Grumbullimi dhe transporti</u></b></p> <p>Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave mund të ketë ndikim negativ të cilësisë së ujit, si pasojë e grumbullimit dhe skladimit jo të rregullt, balotazhit potencial nga paketimi i mbeturinave, filtrit nga mbeturina e gjelbër dhe balotazhi i pikave të gjelbëra, stacioneve për mbingarkim, larja e veturave dhe pajisja e aksidenteve të mundshme gjatë transportit të mbeturinave.</p> <p>Natyra e efektit do të varet nga karakteristikat e rajonit të grumbullimit, llojit të enëve për grumbullim, llojit të automjeteve, rrugës transportuese dhe karakteristikave të tokës dhe në mënyrë precize do të definohen në nivel të projektit.</p> <p><b><u>Kapacitetet mekanike dhe recikluese (KMR)</u></b></p> <p>Ka një potencial KMR të shkaktojë efekte lokale negative të tokës përmes derdhjeve aksidenciale të ujit të ndotur ose rrjedhjes, fundrinës së sedimenteve të ajërit etj. Më tej KMR do të prodhoj mbetje të mbeturinave që do të deponohet në këtë deponi.</p> <p><b><u>Stabilizimi mekanik dhe biologjik (SMB)</u></b></p> <p>Proceset e SMB mund të kenë efekte negative të tokës edhe pse rezultati i derdhjeve aksidenciale të ujit të ndotur ose rrjedhjes, kullimit të filtrit, fundrinës së sedimenteve nga ajëri etj. Më tej, ndikimet ndaj tokës do të varen nga cilësia e mbetjes së materialit - CLO. Ndikimet do të varen nga shkalla e përpunimit të mbetjes së materialeve dhe zbatimit të tyre përfundimtar.</p> <p>Ekziston një mundësi që sipërfaqja e rëndësishme e ndotësëve internë të mbetet në prodhimin e procesit të SMB -CLO që do të rezultojë me marrjen e CLO me një cilësi të ulët (ky lloj i CLO mund të shfrytëzohet vetëm për mbulimin e deponisë ose për rindërtimn e deponisë). Që të shmanget kjo, është e domozdoshme që të kryhet një skladium i gjerë i këtyre ndotësëve inert në procesin e SMB.</p> <p>Koha e gjatë e mbajtjes për stabilizimin e mbeturinave mund të kërkoj tokë të rëndësishme sipërfaqësore për zhvillimin e materialit, që nga ana tjetër mund ti tangoj pronarët e tokës.</p> <p><b><u>Kompostimi i brazdave kompostimi në hapësirë të hapur</u></b></p> <p>Instalimi i kompostimit në brazdat do të ketë ndikim negativ të tokës si rezultat i derdhjes aksidenciale të ujit të ndotur ose rrjedhjes, kullimit të filtrit, kompostit të kontaminuar etj. Ndotja e kompostit nga mbeturina e gjelbër mund të rezultojë nga ndotësia ulët – intern (qelq, plastik dhe metal), që zakonisht mënjanohe me kombinimin e inspektimit dhe rrjedhave vizuale. Nga aspekti i kontaminimit me metalet e rënda, mbeturina e gjelbër është ndoshta më pak ushqim i kontaminuar i kafshëve. Materialet e mbeturinave, që përdoren për kompostim, mund të përmbajë një numër të ndotësve organike (pesticideve, prodhimeve farmaceutike, ndotësve industrial) që mund të shkaktojë ndotjen e tokës.</p> <p><b><u>Deponija</u></b></p>



	<p>Mënjanimi i mbeturinës tjetër të deponisë mund të ketë efekte negative të tokës për shkak të derdhjes aksidenciale të ujit të kulluar, filtrit, mbetjes së ndotur etj.</p> <p>Gjithashtu, toka mund të lëndohet ndjeshëm nga aktivitetet e deponisë, sidomos për marrjen e tokavetë mëdha sipëfaqësore (sasia e tokës që do të mënjanohet dhe do të skladohet gjatë ndërtimit dhe realizimit të sheshit të ndërtimeve). Shkalla e ndikimit varet nga kushtet gjeologjike dhe gjeomorfologjike në terren.</p> <p><b><u>Rrindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta/të egra</u></b></p> <p>Rindërtimi i deponive ekzistuese mund të shkaktojë një ndikim negativ në tokë. Vëllimi intensiv i këtijë ndikimi pritët në fazën e ndërtimit, por gjenerimi i filtrit do të vazhdojë edhe pas restaurimit të tij; sipas kësaj nuk përjashtohet mundësia për ndikimin e tokës nga modelet e propozuara.</p> <p>Nuk pritët që Modeli „A“ i këtij opsioni-deponimi i mbeturinës me metodën „ex-situ“ të shkaktoj ndikime negative ndaj tokës pas fazës së rindërtimit, sepse lokacioni do të pastrohet, ndërsa mbeturina e mënjanuar do të deponohet në deponit komunale.</p> <p>Modelet tjera të „in situ“ rindërtim mund të shkaktojnë ndikime negative ndaj tokës si pasojë e filtrit, duke pasur para sysh ate se krahas rindërtimit, mbeturina e deponuar do të vazhdojë që të gjeneroj filtrat. Ndikimi i mundshëm potencial ndaj tokës i shkaktohet nga filtri do të varet nga masat e zbatuara për trajtimin e filtrit. Ndikimi i mundshëm i këtyre aktivitetëve do të analizohet më detajisht në nivel të projektit.</p>
<p><i>Përmirësimi i cilësisë së ajërimit dhe reduktimit të emisionëve të gazrave serë</i></p>	<p>Aktivitetet e shumta të skenarit të zgjedhur të PRMM mund të kenë ndikim negativ të cilësisë së ajërimit si rezultat i gjenerimit të pluhurit, bio-aerosoleve, emisionëve të komunikacionit, gazit të deponisë dhe gazit të bymuar nga djegia e gazit të deponisë, aroma e pakëndshme, bakteriet dhe dëmtuesit, inseketet, mbeturinat e lëngshme, shqetësimi nga zhurma, në rastë të zgjidhjes së paregullt të lokacionit ku do të vendosen kapacitetet për menaxhimin e mbeturinave dhe masa joadekuata dhe mirëmbajtja e procesit dhe kapaciteteve. Duke pasur para sysh faktin se të gjitha aktivitetet e theksuara janë të lidhura me zbatimin e aktivitetëve të veçanta të projekteve, vlerësimi i saktë i ndikimit do të zbatohet në nivel të projektit.</p> <p><b><u>Grumbullimi i transportit</u></b></p> <p>Aktivitetet e transportit të mbeturinave mund të kenë ndikime negative të cilësisë së ajërimit, si pasojë e grumbullimit dhe skaldimit. Grumbullimi jo i rregullt i mbeturinave biodegradable mund të rezultojë me gazrat serë, aromën e pakëndshme, bakteriet etj gjithashtu, lloje të tjera të kapaciteteve, siç janë pikat e gjelbra, stacionet për mbingarkim dhe rrjedhat e mbeturinave (mbeturinat nga paketimi) mund të gjenerojnë bio-aerosol, pluhur, komponenta të avullueshme organike, aromë të pakëndshme, bakterie, këpurdha etj.</p> <p>Grumbullimi i ndarë i mbeturinave kërkon një numër të madh të llojeve të ndryshme të automjeteve. Transporti i mbeturinave mund të bëhet në distanca të mëdha, që mund të çoj deri te emisionet e gazrave serë, pluhurit, emisionëve të NOx, aromës së pakëndshme etj.</p> <p>Natyrë e efektit do të varet nga lloji i enëve për grumbullimin, llojin e automjeteve, rrugës transportuese, lokacionit të hapësirës për skladimin dhe kapacitetin e ajërimit ambiental.</p> <p>Gjithashtu, këto aktivitete do të shkaktojnë nivel të rritur të zhurmës, që mund të shkaktojë ndikim negativ të popullatës dhe faunës ekzistuese.</p> <p><b><u>Kapaciteti mekanik dhe riciklues (KMR)</u></b></p> <p>KMR do të gjenerojnë emisione fillestare fugitive në ajër, si rezultat i veprimit të mbeturinave dhe sortimit të së njejtës.</p> <p>Emisionet ka mundësi që potencialisht të rriten nëse mbeturina mbetet në kapacitetin e periudhës më të gjatë kohore. Kjo mund të risë emisionet nga aroma e pakëndshme dhe potencialisht mikroorganizmat. Mendohet se nuk ka probabilitet që KMR të shkaktojë ndikime të rëndësishme ndaj cilësisë së ajërimit.</p> <p>Zhurma mund të jetë një problem potencial te KMR, gjatë operacionëve të caktuara, siç është trajtimi i qelqit.</p> <p><b><u>Stabilizimi mekanik dhe biologjik (SMB)</u></b></p>



Funksionimi i sistemeve të SMB do të rezultojë me ndikimin e cilësisë së ajërit, përmes emisioneve bio-arosole, pluhurit, komponentëve organik të avullueshëm dhe aromës së pakëndshme. Mirëmbajtja jo e rregullt e rrezervave të kompostit, gjatë procesit të kompostimit do të rezultojë me gazrat e lëshuara që mund të shkaktojnë një efekt negativ. Kur shtresat përkatësisht nuk anaerohen, kolonat e bakterieve anaerobe lulëzojnë dhe prodhojnë gaz metan. Procesi i shpërbërjes, gjithashtu lëshon dioksid të karbonit, komponenta të avullueshme organike, bakterie dhe kërpudha.

Lëshimi i metanit dhe dioksidit të karbonit kontribuon në ndryshimet klimatike. Ndotësit keq të menaxhuar shkaktojnë edhe aromë të pakëndshme.

Emisioni i aromës së pakëndshme që gjenerohet me kompostimin e mbeturinave shkakton ankesa nga njerëzit. Në krahasim me format tjera të kompostimit të mbetjeve të mbeturinave do të ketë një emision të reduktuar të aromës së pakëndshme si rezultat i përdorimit të sistemit të mbulimit (membranë).

#### **Kompostimi në brazda – kompostimi në hapësirë të hapur**

Emisionet nga kompostimi i brazdave ndërlidhen me procesin e mbindërtimit, që shkakton lërimin e  $N_2O$ ,  $NH_3$ ,  $CH_4$ , VOCs,  $CO_2$ , bakterieve, këpurdhave dhe aromës së pakëndshme. Gazrat që lirohen shtresat përktëse të mirëmbajtura të kompostit të ndërlidhura me procesin e kompostimit, do të kenë efekt negativ të cilësisë së ajrit ambiental. Lëshimi i metanit dhe dioksidit të karbonit kontribuon drejt ndryshimeve klimatike. Instalimet e menaxhuara keq për kompostim shkaktojnë edhe aromë të pakëndshme, nga mbeturinat që kompostohen. Një pjesë e madhe e njerëzve ankohen nga emisionet e aromës së pakëndshme gjatë kompostimit të mbeturinave.

#### **Deponija**

Deponimi mund të rezultojë me një numër të caktuar të efekteve të cilësisë së ajërit lokal, si nga emisionet sipërfaqësore të komponentave të avullueshme organike të gazit të deponisë, komponentat e avullueshme organike nga emisionet e sipërfaqes mund të shoqërohen me një aromë të pakëndshme.

Gazi i deponisë është i përbërë nga disa gazra, por kryesisht nga metani ( $CH_4$ ) dhe dioksidi i karbonit ( $CO_2$ ). Gjithashtu përmban përbërës tjer të vogël, siç janë hidrokarburet, sulfuri i hidrogjenit ( $H_2S$ ), amonjaku ( $NH_3$ ), komponime organike të oksigjenuara dhe e halogjenuara.

Nga pesë deri në tetë vitet e para të punës, gazi i deponisë do të digjet, duke pasur para sysh ate që prodhimi i gazit të deponisë është shumë i vogël sipas sasisë dhe me një cilësi të dobët që të përdoret për prodhimin e energjisë.

Emisionet nga nus-prodhimet nga djegia e gazit të deponisë përfshijnë  $NO_x$ , CO, PM dhe dioksidet e përgjithshme / furane.

Gjithashtu, lokacioni i deponisë do të gjenerohen emisione nga djegia e automjeteve për mbeturina. Të gjitha emisionet e caktuara mund të shkaktojnë ndikim negativ të cilësisë së ajërit dhe të kontribuojnë drejt ndryshimeve klimatike në nivel lokal, rajonal dhe global.

Është e rëndësishme që të theksohet se gjenerimi i gazit të deponisë do të vazhdojë edhe pas mbylljes së deponisë.

Efektet tjera ndaj mjedisit jetësor, të lidhura me deponitë, mund të përfshijnë migrimin e gazit/rreziqeve nga eksploatimi, shkatërimin vizuel dhe mbeturina e lëshshme.

Aroma e pakëndshme mund që të ndihet edhe me një distancë prej 500 m, që në këtë mënyrë mund të jetë një shkak për ankese. Megjithatë, efektet e mundshme do të varen nga natyra e mbeturinave që mënjahen, projektit të deponisë, shkallës së mbledhjes të gazit të deponisë, kushtet e motit dhe afërsisë / orientimit recipientëve të ndjeshëm.

Paralelisht me zgjerimin e grumbullimit dhe djegien e gazit të deponisë të të gjithë deponisë, pritet ndikimi i aromës së pakëndshme nga deponia që të reduktohet.

Deponia e planifikuar rajonale do të jetë moderne dhe në pajtim me kërkesat ligjore dhe standardet e BE-së dhe legjislaturës kombëtare, që përfshinë masa për mbrojtjen e ajrit ambiental.

#### **Rindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta/ të egra**

Ripërtërtimi i deponive ekzistuese mund të shkaktojë një ndikim negativ të cilësisë së ajërit.



	<p>Një vëllim më intensiv i këtij ndikimi pritet në fazën e ripërtrirjes, por gjenerimi i deponisë së gazit do të vazhdojë edhe sipas ripërtrirjes së tij; sipas kësaj, nuk përjashtohet mundësia për ndikimin e ajërit nga modelet e propozuara</p> <p>Nuk pritet që Modeli „A” i opsionit –Deponimi i mbeturinave me metodën „ex-situ” të shkaktoj ndikime negative ndaj cilësisë së ajërit sipas fazës së ripërtrirjes, sepse lokacioni do të pastrohet, ndërsa mbeturina e mënjeluar do të deponohet në deponitë komunale.</p> <p>Metodat për ripërtrirje „in situ” mund të shkaktojnë ndikime negative ndaj cilësisë së ajrit ambiental, si pasojë nga gazi i deponisë së gjeneruar, i cili do të vazhdojë që të gjenerohet edhe pas mbylljes së deponisë. Ndikimi i mundshëm negativ ndaj cilësisë së ajërit i shkaktohet nga gazi i deponisë do të varet nga masat e zbatuara për nxjerrjen dhe trajtimin e deponisë. Ndikimi i mundshëm i këtyre aktiviteteve do të analizohen në detaje në nivel projektsh.</p>
<p><i>Përmirësimi dhe mbrojtja e të mirave materiale</i></p>	<p>Zgjedhja joadekuarte e lokacionit për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin me mbeturinat dhe mirëmbajtjen e parregulltë të proceseve në kapacitetin, si dhe në grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave të krijuara mund të ndikojë në përmbajtjet materiale lokale të tilla si rrugët, kanalizimet, ujësjellësit, rrjetet e energjisë, etj.</p> <p><b><u>Grumbullimi i transportit</u></b></p> <p>Transporti i paqëndrueshëm i mbeturinave do të shkaktojë një ndikim negativ në rrugët lokale dhe rajonale.</p> <p>Po ashtu, mbledhja e paligjshme e mbeturinave nga popullata, për shembull me përzjerjen fraksionet e ndryshme të mbeturinave në kontenerët që nuk janë të përshtatshme për këto lloje të mbeturinave do të rrisë aktivitetet operative në kapacitetet tjera të trajtimit. Kjo do të rezultojë me rritjen e konsumit të lëndëve të para dhe gjenerimin në sasi të konsiderueshme të fraksioneve të përgatitura për deponim.</p> <p>Stacionet e gjelbëra dhe stacionet e mbingarkimit mund të shkaktojë efekte negative ndaj të mirave materiale, si rezultat i pushtimit të tokës për ngritjen e kapaciteteve, konsumit të energjisë dhe ujit, ngarkesën e kanalizimeve, etj.</p> <p><b><u>Kapacitete mekanike dhe ricikluese (KMC)</u></b></p> <p>Mbeturinat nga KMC që nuk posedojnë një vlerë ekonomike, do të deponohen në deponi. Nëse aktivitetet e KMC nuk janë adekuarte, sasia e mbeturinave të deponuara në deponi do të rritet dhe do të shkaktojë ndikim negativ të të mirave materiale.</p> <p>KMC mund të shkaktoj ndikim negativ të mirave materiale si rezultat i përfshirjes së tokës për ngritjen e kapaciteteve, konsumit të energjisë dhe ujit, mbingarkimit të kanalizimit etj.</p> <p><b><u>Stabilizimi mekanik dhe biologjik (SMB)</u></b></p> <p>Mbeturinat nga SMB që nuk kanë vlerë ekonomike do të deponohen në deponi. Parashikohet se 50-55% nga mbeturinat mund të diversohen nda deponimi në deponi, edhe pse rreth gjysma e këtij diversioni mund të jetë për shkak të materialeve që përdoren në rindërtimin ose menaxhimin e lokacionit. Nëse aktivitetet e SMB nuk janë të përshtatshme, sasia e mbeturinave të deponuara në deponi do të rritet dhe do të shkaktojë një ndikim negativ të të mirave materiale.</p> <p>SMB mund të shkaktojë një ndikim negativ të të mirave materiale, si rezultat i përfshirjes së tokës për ngritjen e kapaciteteve, CLO së prodhuar, konsumit të energjisë dhe ujit, mbingarkimin e kanalizimit, etj.</p> <p><b><u>Kompostimi në brazda – kompostimi në hapësirë të hapur</u></b></p> <p>Kompostimi në brazda mund të shkaktoj një ndikim negativ i të mirave materiale, si rezultat i përfshirjes së tokës për ngritjen e kapaciteteve, kompostit të prodhuar , konsumit të energjisë dhe ujit dhe mbingarkimin e kanalizimit etj.</p> <p><b><u>Deponija</u></b></p> <p>Deponia rajonale e mbeturinave mund të shkaktoj një ndikim negativ të të mirave materiale, si rezultat i përfshirjes së tokës për ngritjen e kapaciteteve, konsumit të energjisë, konsumit të ujit dhe mbingarkimin e kanalizimit etj.</p> <p>Të gjitha ndikimet të cituara më lartë për të gjitha opsionet do të varen nga kapaciteti i</p>



	<p>fuqisë së rrjetit të infrastrukturës ekzistuese dhe kapacitetit të instalimeve.</p> <p><b>Rindërtimi i deponive ekzistuese të parregullta/ të egra</b></p> <p>Ripërtrtimi i deponive ekzistuese me zbatimin e metodës ex-situ“mund të shkaktojë një ndikim negativ ndaj të mirave materiale gjatë aktiviteteve për rindërtim edhe më tej. Mbeturinat e deponuara në depotitë ekzistuese do të mënjanoen në tërësi dhe do të deponohen në deponi komunale. Me këtë do të rritet kapaciteti i deponive komunale,, sipërfaqes së tokës për deponim dhe sasia e filtrit dhe gazit të deponisë që duhet të trajtohen. Një trajtim i këllillë është i lidhur me konsumin e rritur të energjisë, ujit, mbingarkimit të kanalizimeve etj. Vlerësim i veçantë i ndikimit do të kryhet në nivel të projekteve.</p>
<i>Mbrojtja dhe avancimi i trashëgimisë kulturore</i>	<p>Masat dhe aktivitetet të përfshira në skenari C3b dhe rindërtimin e deponive ekzistuese të parregullta/ të egra nuk do të realizohet në lokacionet ose rajonet të shpallura si trashëgimi kulturore.</p>
<i>Rruajtja e karakteristikave të peizazhit dhe mbrojtja e peizazhit kudo, ndërsa në veçanti rajonet e mbrojtura</i>	<p>Të gjitha aktivitetet nga skenari i propozuar mund të kenë ndikim negativ ndaj peizazhit. Duhet të theksohet se RVL posedon mjedis të veçantë dhe rajone të mbrojtura, që kanë vlerë për bashkësinë lokale dhe turistët. Sipas kësaj, është shumë e rëndësishme kjo çështje të merret para sysh gjatë zgjidhjes së lokacioneve për menaxhim me mbeturinat. PRMM përjashton lokacione me peisazh karakteristik ose lokalitete të mbrojtura për krijimin e kapaciteteve për menaxhimin me mbeturina.</p> <p><b>Grumbullimi I transportit</b></p> <p>Grumbullimi i transportit mund të ketë ndikim potencial në aspektin vizual si rezultat i numrit të ritur të kovave për grumbullimin e mbeturinave, madhësisë dhe ngjyrës së tyre, mbeturinës së lëngshme etj. Natyra e efektit do të varet nga lokacioni për vendosjen e kovave për grumbullim, mbledhjen e shpeshtë të mbeturinave, periudhën e skadimit të përkohshëm etj.</p> <p><b>Opsionet tjera</b></p> <p>Të gjitha kapacitetet për menaxhimin e mbeturinave do të centralizohen në nivel rajonal dhe ka mundësi që të ketë nevojë për më shumë hapësirë, që mund të shkaktojë një ndikim negativ në peisazhet. Një efekt tjetër mund të lidhet me prishjen vizuale, mbeturinat e hudhra të shpërndara, sklادين e materialit të riciklueshëm, kompostit, materialeve të gërmuara dhe materialeve për mbulimin e deponisë etj.</p> <p>Natyrë e efektit do të varet nga lokacioni, udhëheqja e aktiviteteve punuese, trajtimin e materialeve etj.</p> <p>Rindërtimi i deponive ekzistuese mund të shkaktojë një ndikim negativ ndaj peisazhit, sidomos në rast të zbatimit të metodës ex-situ (në fazën e ndërtimit). Ndikimet e mundshme të këtyre aktiviteteve do të përcaktohen dhe do të vlerësohen në nivel të projektit. Pas ripërtrirjes së deponisë, nuk priten ndikime negative, ndërsa këto lokacione mund të përdoren si parqe, shesh lojrash, etj.</p>

**Tabela 4** Ndikimet kumulative dhe sinergjike të shkaktuara nga realizimi I aktiviteteve në skenarin e rekomanduar 3b dhe rindërtimin e deponive ekzistuese të parregullta/të egra

Tema e VSMJ	Ndikimet e mundshme
<b>Popullata</b>	<p>Ndikimet pozitive kumulative dhe sinergjike do të arrihen me zbatimin e skenarit të rekomanduar C3b, ndërsa rindërtimi i deponive ekzistuese (për të cilat mendohet se paraqesin një ndikim të rëndësishëm negativ ndaj mjedisit jetësor) do të kontribuojë në reduktimin e rrezikut për shëndetin e njerëzve në këtë rajon.</p> <p>Materiali i prodhuar i ricikluar do të shkaktojë ndikime kumulative pozitive dhe sinergji të zhvillimit të ekonomisë, bujqësisë etj.</p> <p>Efektet kumulative kryesisht janë të ndërlidhura me ndikimet e bashkësive lokale në rrethinën e infrastrukturës së re, nga aspekti i pluhurit, aromës së pakëndshme, zhurmës dhe numrit të rritur të komunikacionit, ndotjes së ujit dhe tokës. Transporti i ngarkuar I emisionit nga automjetet do të shkaktojë ndikime kumulative dhe sinergjike ndaj shëndetit të njerëzve.</p> <p>Natyrë e ndikimit do të varet nga lokacioni i mirëmbajtjes së kapacitetit të menaxhimit me</p>



	mbeturinat, si dhe ndikimet e shkaktuar nga aktivitetet zhvillimore për të gjithë rajonin.
<b>Biodiversiteti, flora dhe fauna</b>	Realizimi i skenarit të rekomanduar C3b dhe rindërtimi i lokacioneve ekzistuese (duke përfshirë mbylljen dhe rehabilitimin e deponive të egra, reduktimin e mbeturinave në minimum dhe praktikën më të mira për menaxhimin e mbeturinave) pritet që të rezultojë në ndikimet përgjithësisht pozitive kumulative dhe sinergjike të natyrës në përgjithësi dhe në veçanti në cilësinë e vendbanimeve dhe mbrojtjen e llojeve të florës dhe faunës. Ndikimet negative kumulative kryesisht janë të ndërlidhura me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe kapaciteteve për menaxhimin me mbeturinat, si dhe ndikimin e aktiviteteve të zhvillimit në të gjithë rajonin.
<b>Toka</b>	Ndikimet pozitive kumulative dhe sinergjike do të arrihen me zbatimin e skenarëve të rekomanduar C3b dhe rindërtimin e deponive ekzistuese, që do të kontribuojnë në reduktimin e ndotjes së tokës në rajon. Ndikimet negative kumulative mund të paraqiten kryesisht si rezultat i lokacionit dhe mirëmbajtjes së kapaciteteve për menaxhimin me mbeturinat, si dhe ndikimet nga aktivitetet zhvillimore në të gjithë rajonin.
<b>Uji</b>	Ndikimet pozitive kumulative dhe sinergjike do të arrihen me zbatimin e skenarëve të rekomanduar C3b dhe rindërtimin e deponive ekzistuese, që do të kontribuojnë në reduktimin e ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në rajon . Ndikimet negative kumulative kryesisht janë të ndërlidhura me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe kapaciteteve për menaxhimin me mbeturinat, si dhe ndikimin e aktiviteteve të zhvillimit në të gjithë rajonin. Ky ndikim varet nga numri i kapaciteteve të reja të rekomanduara, lokacionet, d.m.th afërsia e rrjedhave të ujit. Ndikimet kumulative dhe sinergjike të ujit do të varen nga cilësia e ujërave të derdhura të ndotura në recipientët dhe karakteristikat cilësore dhe kuantitative të recipientit.
<b>Ajri</b>	Ndikimet pozitive kumulative dhe sinergjike do të arrihen me zbatimin e skenarëve të rekomanduar C3b dhe rindërtimin e deponive ekzistuese. Opsionet për riciklimin e ripërdorimit të mbeturinave do të kontribuojnë në reduktimin e emisioneve të gazrave serë nga deponia, që mund të jetë një kompensim për energjinë dhe emisionet e karbonit të lidhura me nxjerrjen dhe prodhimin e materialeve natyrore . Ndikimet negative kumulative dhe sinergjike nga opsionet e rekomanduara do të jenë të mundshme në rajonet me cilësi të keqe të ajrit dhe do të varen nga ndikimet e shkaktuara nga aktivitetet zhvillimore në të gjithë rajonin. Emisionet e shkaktuara nga grumbullimi i transportit të mbeturinave do të shkaktojnë ndikime negative kumulative dhe sinergjike.
<b>Peisazhi</b>	Ndikimet pozitive kumulative dhe sinergjike do të arrihen me zbatimin e skenarëve të rekomanduar C3b dhe rindërtimin e deponive ekzistuese. Me këto opsione do të reduktohet/eliminohet praktika e zakonshme të deponimit jolegal të mbeturinave, si dhe nevoja për sipërfaqe më të madhe të tokës për deponim, që do të kontribuojë, ndërsa mënjanimi ose reduktimi në minimum i ndikimeve ndaj peisazhit të trashëgimisë natyrore . Ndikimet negative kumulative kryesisht janë të ndërlidhura me sipërfaqen për vendosjen e infrastrukturës së kapaciteteve për menaxhimin me mbeturinat, në kombinim me zhvillimin tjetër të rajonit.
<b>Të mirat e materialeve dhe efikasiteti i resurseve</b>	Parandalimi, shfrytëzimi i hapësirës dhe riciklimi i mbeturinave, së bashku me trajtimin e mbeturinave tjera, mundësojnë efekte pozitive kumulative dhe sinergjike si rezultat i presionit të reduktuar mbi burimet primare dhe sasinë e zvogëluar të mbeturinave të deponuara në deponi. Ndikimet negative kumulative janë të ndërlidhura me lokacionin dhe madhësinë e zonave për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin me mbeturinat, zhvillimin e zonës përreth, infrastrukturën e ndërtuar, të tilla si kanalizimi, ujësjells, rrugët lokale dhe rajonale, kapaciteti i instalimeve dhe nevoja e tyre për energji elektrike, ujë, kanalizimi, n sasinë e mbeturinave që deponohen me modelin ex situ, etj.



## 1.9 Masat për zbutje

Ndikimet ndaj mediave të veçanta të mjedisit jetësor do të eliminohen ose përmirësohen në mënyrë efektive, nëse gjatë realizimit të aktiviteteve të propozuara në Planin apo veprimet që rezultojnë nga projektet tjera konkrete merren para sysh masat e përcaktuara në vlerësimin strategjik të mjedisit jetësor. Më tej, masat që do të dalin nga raportet individuale të projekteve në një nivel më të ulët (studimi i vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit jetësor ose elaborati), ndërsa duhet të merren në konsideratë edhe të zbatohen masat nga procedura për parandalimin e integruar dhe kontrollin e ndotjes (PIKN). Masat zbutëse janë të detajuara në kapitullin 10.

## 1.10 Plani për monitorimin mbi zbatimin e planit nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit jetësor

Vlerësimi Strategjik i Mjedisit Jetësor përfshin monitorim mbi zbatimin e dokumentit dhe planit dhe mbi të gjitha ndikimet e identifikuara pozitive dhe negative që do të rezultojnë nga zbatimi i opsionit dhe aktiviteteve të propozuara në Planin rajonal për menaxhimin me mbeturinat për rajonin verilindor. Plani për monitorim është sqaruar më detajisht në Kapitullin 11.

## 1.11 Përfundimet dhe rekomandimet

### 1.11.1 Përfundimet

- **Gjendja aktuale e sistemit për menaxhimin me mbeturina (SMM):**
  - Ekziston Strategjia kombëtare për menaxhimin me mbeturinat (SKMM) dhe Plani 5 vjeçarë kombëtar për menaxhimin me mbeturinat (PKMM), i miratuar në vitin 2009. Hierarkia e menaxhimit të mbeturinave është reflektuar pothuajse plotësisht në PNMM, por hierarkia e mbeturinave nuk zbatohet, duke pasur para sysh ate nuk merren masa për parandalim të mbeturinave, sistemi i mbledhjes së mbeturinave nuk separohet në burim dhe nuk ekzistojnë aktivitete formale të riciklimit.
  - MMJPH është organ kombëtarë udhëheqës kompetent për menaxhimin me mbeturina. Kohëve të fundit është formuar Bord ndërkomunal për menaxhimin me mbeturina. Ende nuk është themeluara ndërmarrja rajonale për menaxhimin me mbeturina.
  - Politika e pagesës në rajon nuk është e balancuar. Prandaj, një numër i madh i ndërmarrjeve publike komunale vuajnë nga mungesa e mjeteve, që ndikon në mirëmbajtjen e duhur të kapaciteteve ekzistuese, grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave.
  - Shpesh organizohen fushata për ngritjen e vetëdijes së publikut, mirëpo për shkak të mungesës së ciklit të themeluar të mbeturinave, shumica prej tyre nuk janë të zbatueshme.
  - Ekziston dallimi i kapacitetit (teknik dhe administrativ) midis ndërmarrjeve të komunave komunale në rajon.
  - Pesë (5) deponitë komunale, edhe pse janë të organizuara, nuk i plotësojnë kërkesat e BE-së. Ekzistojnë 36 deponi të egra të pakontrolluara, që paraqesin një rrezik të rëndësishëm për mjedisin jetësor. Qëllimi i përcaktuar në PNMM për deponimin e 50% nga mbeturinat e përgjithshme të forta komunale në kapacitetet që i plotësojnë kushtet e BE-së dei në vitin 2014, me siguri nuk mund të arrihet.





- **Për PRMM**

**Në përgjithësi**

- Nevojat për menaxhimin me mbeturinat plotësohen në nivel rajonal dhe të njëjtat janë në pajtim me SKMM dhe PNMM, si dhe kërkesat e direktivave të mbeturinave.
- PRMM është një dokument gjithëpërfshirës, që është në pajtim me hierarkinë e mbeturinave dhe analizon disa opsione, masa dhe aktivitete me qëllim që ti plotësoj kërkesat themelore sipas hierarkisë së mbeturinave, përkatësisht:
  - ✓ Parandalimi i mbeturinave dhe reduktimi i tyre në minimum (aktivitetet për ngritjen e vetëdijes, përgatitja e udhëzimeve për parandalimin, kërkimin dhe zhvillimin dhe kompostimit shtëpiak, i dedikuar kryesisht për avisitë rurale).
  - ✓ Grumbullimi i mbeturinave (janë analizuar opsionet për mbledhjen e mbeturinave të përziera, grumbullimin e materialeve të thata që mund të riciklohen, mbledhja e bio-mbeturinave, pikave të gjelbëra, opsioneve për mbingarkimin e mbeturinave dhe janë propozuar shembuj konkret).
  - ✓ Opsionet për riciklimin dhe përdorimin (kapacitete për përdorimin e materialeve – KPM, riciklimi i bio-mbeturinave, stacione për trajtimin mekaniko-biologjik (SMB), stabilizimi mekaniko-biologjik (SMB) grimcim),
  - ✓ Opsione për përdorimin e mbeturinave (trajtim termik i mbeturinës së fortë ose oksidim termik ose insenerim),
  - ✓ Opsione për deponimin e mbeturinave (deponia).
- PRMM nuk ka për qëllim të propozoj lokacion të identifikuar për deponinë e ardhshme rajonale.
- Në PRMM janë përpunuar praktika të mira dhe njohuri në lidhje me grumbullimin dhe transportin, por nuk është përcaktuar më e dobishmja për rajonin, sipas gjendjes ekzistuese socio-ekonomike dhe gjeografike. Kjo duhet të bëhet në hapin e ardhshëm (Studimet e Fizibilitetit).
- Në bazë të vlerësimit të detajuar të alternativave ( 4 skenar bazë dhe 3 nënskenare ) përmes analizës së kriterëve të shumta ( kriteret ligjore, kriteret për mbrojtjen e mjedisit jetësor, kriteret teknologjike, kriteret ekonomike), duke përdorur modelin ELECTRE III, projekti RPUO propozon tre skenarë për menaxhimin e integruar të mbeturinave në rajon , psh .: Skenari S3b, pastaj Skenari C2 dhe Skenari C1a. Skenari më i rekomandueshëm për rajonin verilindor është C3b. Skenari C3b për menaxhimin e integruar të mbeturinave në rajon , i përfshin opsionet e mëposhtme:
  - ✓ Grumbullimi- sistemi i grumbullimit me dy kova (kova për mbeturina që mund të riciklohet edhe kova për mbeturinat tjera), pikat e gjelbëra, grumbullimi veçmas i mbeturinave të gjelbëra,
  - ✓ Trajtimi i kovës së mbeturinave që mund të riciklohet – Kapaciteti për përdorimin e materialeve (KPM)
  - ✓ Trajtimi i kovës për mbeturinën tjetër – Stabilizimi mekanik dhe biologjik (SMB)
  - ✓ Trajtimi i mbeturinës së gjelbër – Kompostimi në brazda – kompostimi në hapësirë të hapur,
  - ✓ Trajtimi i burimit: Kompostimi shtëpiak,
  - ✓ Deponia – deponia për mbeturinat tjera.



- Janë prezantuar metodat për rivitalizimin/ sanimin e 5 deponive komunale dhe 36 deponive të egra, që do të përpunohen plotësisht në nivel të projektit.

- **Përfundime, për procesin e VSMJ**

#### Në përgjithësi

- Procesi i VSMJ filloi së bashku me procesin e planifikimit dhe të dy proceset janë integruar në një proces të përbashkët. Me këtë koncept kursehet koha dhe rritet efikasiteti.
- Organizimi i ekipit të VSMJ përbëhet nga ekspertët e VSMJ, ekspertët për planifikimin e organeve të tanguara (në nivelin kombëtar, rajonal dhe lokal). Përfitimi kryesor është grumbullimi i pikëpamjeve të ndryshme gjatë gjithë procesit, në kontinuitet.
- U siguroa trajnim për palët e interesuara kryesore, më qëllim që të gjithë të kyçen tërësisht në procesin e VSMJ.
- Procesi i prezencës së publikut filloi me publikim e Vendimit për zbatimin e VSMJ-së në ueb faqet e MMJPH, rajonit dhe komunave.
- Bashkëpunimi midis ekipeve të VSMJ-së dhe planifikimit, si dhe me palët e interesuara kryesore (komunat dhe ndërmarrjet publike komunale nga rajoni) ofron një mundësi që të arrihet një zgjidhje e përbashkët e planit të gjerrë dhe i mbështetur, që u krijua nga pikëpamjet e ndryshme dhe që në mënyrë të barabartë u morr aspekti i mbrojtjes së mjedisit jetësor.
- Qëllimet e përgjithshme të mbrojtjes së mjedisit jetësor u krahasuan me të njëjta nga PRMM, që të eliminohen mospërputhjet apo keqkuptimet. Plotësisht, qëllimet e VSMJ-së u krahasuan me qëllimet e strategjive dhe planeve ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale.
- Gjatë procesit të VSMJ, u identifikuan disa rajone të ndjeshme natyrore. Rajoni më i rëndësishëm i zogjve (RRZ) Pçinja-Petroshniçka Reka përfshinë një sipërfaqe të madhe rreth luginave të lumenjëve Pçinjë, Petroshniçkë dhe Kriva Rekë. Ky rajon është shpallur për shkak të disa llojeve të rëndësishme të zogjve, siç janë
- Kobëza e bardhë, (*Neophron percnopterus*), Sorra e kaltër (*Coracias garrulus*), Lejleku i zi (*Ciconia nigra*), Petriti bishtbardhë (*Buteo rufinus*), Shqiponja perandorake (*Aquila heliaca*) dhe tjera. Popullata më të rëndësishme të këtyre llojeve të zogjve gjenden në luginat e lumejëve të lartëpërmendur, sidomos në vendet shkëmbore. Nga aspekti i mbrojtjes së bimëve, si rajon më i rëndësishëm i veçantë i referuar për këtë rajon është RRB Osogovë (rajon i rëndësishëm bimor), që i përfshinë Malet e Osogovës.
- Gjatë procesit të VSMJ-së, u analizuan skenarët alternativ C3b, C2 dhe C1a, si dhe “skenarë pa asnjë aktivitet”. Në bazë të vlerësimit, u përfundua se skenari C3b ka më shumë përfitime<sup>6</sup> dhe ka ndikime më të vogla ndaj mjedisit jetësor në krahasim me skenarët tjerë<sup>7</sup>.

<sup>6</sup> Sistemi i grumbullimit në dy kova të prezentuara në skenarët C3b, të pastër KPM dhe kompostimin shtëpiak jep përparësi përmes marrjes së prodhimit me një cilësi të mirë dhe ndikim më të vogël ndaj mjedisit jetësor i krahasuar me skenarët tjerë .

<sup>7</sup> Kryesisht, të gjitha opsionet në ndarjen janë të njëjta, rezultojnë me ndikime të ngjashme dhe kyçin teknologji të njëjtë për trajtimin e mbeturinave. Dallimet janë vetëm në llojin e trajtimit mekanik (KPM i pastër dhe i papastër) , kompostimi i mbeturinës organike dhe të gjelbër dhe cilësia e materialit të fituar të ricikluar.



- Në raportin e VSMJ është bërë një analizë e thjeshtë dhe transparente e ndikimit (qasje më e gjerë, por me më pak thellësi dhe më shumë përshkrim cilësor të efekteteve dhe pasojave rreth analizave të hollësishme dhe kuantitative të ndikimeve të veçanta) dhe masave të përshtatshme të propozuara.

#### 1.11.2 Rekomandimet

- Të ndiqet rasti hulumtues dhe të vazhdohet me procesin e planifikimit të VSMJ paralelisht dhe në bashkëpunim të ngushtë në kuadër të ekipit të projektit edhe me subjektet kryesore të involvuara.
- Të vendosen struktura efektive institucionale dhe organizative në të gjitha fazat e realizimit të sistemit të ri integruar për menaxhimin me mbeturinat (në nivel lokal dhe rajonal).
- Të përgatitet një version më i thjeshtë i Planit aksional për menaxhimin rajonal të mbeturinave, që do të përmbajë opsionet, masat dhe aksionet që janë më të përshtatshme për rajonin verilindor.
- Skenari i rekomanduar dhe opsionet duhet të prezantohet para publikut më të gjerë dhe mendimi i publikut të merret para sysh në versionin përfundimtarë të PRMM.
- Në fazat e ardhshme të zhvillimit të projektit (Studimi i fizibilitetit) duhet të propozohet në cilën komunë, cili llojë i grumbullimit të mbeturinave është i rekomandueshëm (të propozohet në cilat fshatra mund të vendosen disa metoda të analizuar, kështu që i gjithë rajoni do të aktivizohet dhe do të balancohet ekonomikisht).
- Kur do të zgjidhen lokacionet për kapacitetin e menaxhimit me mbeturinën komunale në RVL, është e domosdoshme që të mënjanohen rajonet kombëtare dhe ndërkombëtare të mbrojtura dhe të shpallura.
- Të gjitha kapacitetet e komplementuara duhet të lokohen afër njëri tjetrit ose në të njëjtin lokacion, që të mënjanohet përhapja e peisazhit dhe ndikimet ndaj pamjeve të disa lokaliteteve, që llogariten për qasje pozitive nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit jetësor.
- Nga praktikat e mira të menaxhimit me mbeturinat të prezantuara në PRMM, në kontekst të gjendjes ekzistuese socio-ekonomike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave (me Studimin e ardhshëm të fizibilitetit).
- Pa marr para sysh atë se transporti dhe rrugët transportuese janë aspektet që mundet në mënyrë të konsiderueshme të ndikojnë ndaj medieve të mjedisit jetësor, rekomandohet që të kryhet një analizë plotësuese e llojeve të alternative të transportit, në fazat e ardhshme të projektit (Studimet e fizibilitetit) dhe të propozohet zgjedhja më e mirë për këtë rajon.
- Gjatë realizimit të aktiviteteve të parapara në PRMM, është e rëndësishme, që në nivel të projektit, të merren para sysh aktivitetet në vijim:
- ✓ Të gjitha kapacitetet e ardhshme do të jenë lëndë të procedurave për VSMJ dhe PIKN.
- ✓ Gjatë identifikimit të lokacioneve për vendosjen e kapaciteteve për menaxhimin me mbeturinat për grumbullimin, riciklimin, përdorimin dhe deponimin, do të shmangen rajonet e mbrojtura ose ato të shpallura të natyrës, rajone të afërta me ujërat



sipërfaqësor dhe nëntokësor, rajone të ndjeshme të tokës, rajone kulturore dhe turistike, si dhe zonat residenciale.

- ✓ Në fazën e ardhshme të zbatimit të projektit, do të jetë e domosdoshme që të zbatohet analiza e problemit të pabarazive të mundshme në qasjen e shërbimeve për riciklimin në kuadër të rajonit.
- ✓ Shfrytëzimi i tokës për kapacitet për menaxhimin me mbeturina duhet të reduktohet në minimum, në masën maksimale të mundshme.
- ✓ Zgjidhja e vendit të lokacionit të kapaciteteve për menaxhimin me mbeturinat duhet të bëhet, duke pasur para sysh disa kritere, siç janë: kriteret e mbrojtjes së mjedisit jetësor, kriteret gjeologjike, teknike dhe ekonomike.

## AUTORITETET KONTRAKTUESE



**MINISTRA E FINANCAVE**  
DEPARTAMENTI QENDRORË PËR FINANCIM DHE KONTRAKTIM

Adresa: Dame Gruev Nr.14, 1000 Shkup  
Web-faqe: <http://cfcd.finance.gov.mk>

## PËRFITUESIT



**MINISTRIA E AMBIENTIT JETËSORE**  
DHE PLANIFIKIMIT HAPSINORË

Adresa: Bul. "Goce Delçev" nr.18,  
Ndërtesa TVMR (kati 10, 11, 12)  
1000 Shkup  
Tel: +389 3 251 400  
Fax: +389 3 220 165  
E-posta: [infoeko@moepp.gov.mk](mailto:infoeko@moepp.gov.mk)  
Web-faqe: [www.moepp.gov.mk](http://www.moepp.gov.mk)



**REGJIONI I**  
**PLANIFIKIMIT**  
**LINDJE**

Adresa: Vanço Prke 119,  
kati 2, 2000 Shtip  
Tel: +389 32 386408/412  
Fax: +389 32 386 409  
[eastregion@rdc.mk](mailto:eastregion@rdc.mk)  
[www.rdc.mk/eastregion](http://www.rdc.mk/eastregion)



**REGJIONI I PLANIFIKIMIT**  
**VERI-LINDJE**

Adresa: Ilindenska pn.,  
1300 Kumanovë,  
P.Fax. 182  
Tel/Fax: +389 31 424 878  
[info@northeastregion.gov.mk](mailto:info@northeastregion.gov.mk)  
[www.northeastregion.gov.mk](http://www.northeastregion.gov.mk)